



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



**MACEDONIAN
CIVIC
EDUCATION
CENTER**



Projekti për Integrim Ndëretnik në Arsim

**RAPORT MBI
HULUMTIMIN ELEKTRONIK
PËR ZBATIMIN
E PINA-s**

Shtator 2016

Hulumtimi është realizuar nga
Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhjen e Konflikteve

Ky hulumtim është përgatitur nga ana e Qendrës për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhjen e Konflikteve dhe Grupit Punues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe është realizuar në bashkëpunim me Qendrën Maqedonase për Edukim Qytetar, si udhëheqëse e projektit. **Autorët e raportit janë Violeta Petroska-Beshka, eksperte për arsim ndëretnik dhe Sara Osmani, koordinatore për monitorim dhe evaluim të Projektit të USAID-it për Integrim Ndëretnik në Arsim.**

PËRMBAJTJA

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	3
Pyetësoni për mbledhjen e të dhënave	3
Procedura e mbledhjes së të dhënave	3
Shkollat e përfshira në hulumtim	4
REZULTATE	13
Sigurimi i kushteve për realizimin e aktiviteteve të PINA-s	14
Realizimi i përgjithshëm i aktiviteteve INA në shkollat	22
Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta me nxënës	25
Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta profesionale për mësuesit	35
Realizimi i aktiviteteve tjera PINA	37
Ndikimi i aktiviteteve INA	41
PËRFUNDIME	44
AKTIVITETET E PËRBASHKËTA PARA DHE PAS PINA-s- Zbulimet dhe rekomandimet	47

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Pyetësi për mbledhjen e të dhënave

Pyetësi i përpiluar për zbatimin e hulumtimit elektronik ka përmbajtur pyetje që kanë siguruar informata të përgjithshme për shkollat dhe pyetje që kanë kërkuar shkollat ta përshkruajnë gjendjen në aspekt të integritimit ndëretnik. Ka pasur disa pyetje shtesë të cilët kanë kërkuar evaluim të efekteve të aktiviteteve PINA. Pyetësi i tërë ka përmbajtur pyetje të njëjta për të gjitha shkollat, përveç disa pyetjeve shtesë për shkollat shumë-gjuhëshe dhe shkollat që kanë së paku 10% të nxënësve që i përkasin pakicave etnike (p.sh. nxënës Romë, Vllahë, Turq, Serbë, Boshnjakë që nuk mësojnë në gjuhën e tyre amtare).

Procedura e mbledhjes së të dhënave

Qasja në faqen e internetit për plotësimin e pyetësit është mundësuar përmes linkut të posaçëm të dhënë në ueb faqen e MASH (<http://mon.gov.mk/index.php/2014-07-23-14-03-24/vesti-i-nastani/1365-elektronsko-istranzuvanje-ucilishta>) që u dërgua deri te secila shkollë. Çdo shkollë mori udhëzime në postën elektronike se si të arrihet deri te pyetësi përmes Internetit dhe fjalëkalimit unik që u mundësoi të kyçen dhe ta plotësojnë pyetësin. Përveç asaj, në shtojcë po ashtu kishte edhe letër me informatë rreth hulumtimit dhe ftesë për pjesëmarrje, të nënshkruar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Pyetësi ishte i hapur për plotësim në periudhën prej 27 Qershor – 8 Korrik 2016, me zgjatje prej dy javë shtesë.

Pas qasjes në faqen e Internetit dhe përfundimit të pyetjeve hyrëse, shkolla automatikisht është përcjellë në strukturën më të përshtatshme të pyetjeve në bazë të përgjigjeve, duke e pasur parasysh gjuhën/t mësimore në shkollë, përqindjen e nxënësve që u përkasin pakicave etnike dhe deklaratën e shkollës në lidhje me përfshirjen në aktivitetet INA.

Janë marrë të gjitha masat parandaluese që të respektohen kërkesat për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje veçmas dhe është mundësuar që plotësimi i pyetësit të bëhet në disa kthesa, kështu që sipas nevojës të korrigjohen përgjigjet derisa shkolla të konfirmojë se pyetësi i plotësuar konsiderohet si përfundimtar.

Progresi i plotësimit të pyetësit është monitoruar me kujdes, gjë që mundësoi gjetjen e gabimeve gjatë procesit, pas së cilës shkollat janë kontaktuar përsëri dhe nga ato është kërkuar ti rikthehen pyetësit përsëri dhe të japin përgjigje të sakta. Për dallim nga viti i kaluar, kur gabimet dhe kërkesat për mbështetje teknike ishin më të shpeshta, këtë vit procesi i plotësimit kaloi më rrjedhshëm.

Shkollat e përfshira në hulumtim

Që nga viti 2015, PINA është prezantuar në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të vendit, dhe si pasojë, pyetësi elektronik u ofrua të gjitha shkollave dhe u plotësua nga pothuajse të gjithë. 93% nga numri i përgjithshëm i 447 shkollave u përgjigjën në pyetësin (94% prej 347 shkollave fillore dhe 88% prej 100 shkollave të mesme).¹ Vetëm 20 prej shkollave fillore dhe 12 shkolla të mesme nuk e kanë plotësuar pyetësin, edhe pse ata kanë qenë të ftuar përsëri. Prej tyre, pesë janë shkolla fillore me dy/ tre gjuhë mësimore (4MSh, 1MT) dhe 15 janë shkolla një-gjuhëshe (8M, 7Sh), ndërsa katër shkolla të mesme janë shumë-gjuhëshe (3MSh, 1MShT) dhe tetë janë shkolla një-gjuhëshe (8M). Pasi që të gjithë ata përbëjnë 7% të numrit të përgjithshëm të shkollave të vendit, nuk pritet që mungesa e tyre nga hulumtimi të ketë ndikim të konsiderueshëm në rezultatet e fituara.

Tabela A. Përshkrimi i shkollave të përfshira në hulumtim

		Shkolla fillore		Shkolla të mesme		
		numri	përqindja	numri	Përqindja	
shkolla shumë-gjuhëshe	MAQ-ShQ	49	52,7	19	63,3	
	MAQ-TUR	20	21,5	4	13,3	
	MAQ-ShQ-TUR	16	17,2	7	23,3	
	MAQ-ShQ-SER	1	1,1			
	MAQ-ShQ-BOSH	1	1,1			
	MAQ-SER	2	2,2			
	TUR-ShQ	3	3,2			
	MAQ-BOSH	1	1,1			
	Gjithsej	93	28,4	30	34,1	
shkolla një-gjuhëshe	të gjitha	MAQ	178	76,1	51	87,9
		ShQ	54	23,1	7	12,1
		TUR	2	0,9		
		Gjithsej	234	71,6	58	65,9
	nga komunitat homogjene	MAQ	73	86,9	41	93,2
		ShQ	11	13,1	3	6,8
		TUR	0			
		Gjithsej	84	25,7 (35,9)	44	50 (75,9)
	nga komunitat heterogjene	MAQ	105	70,0	10	71,4
		ShQ	43	28,7	4	28,6
		TUR	2	1,3		
		Gjithsej	150	45,9 (64,1)	14	15,9 (24,1)
Gjithsej nga numri i përgjithshëm i shkollave		327	78,8	88	21,2	
415						

¹ Në fund të vitit shkollor 2015/16, ka pasur 10 shkolla më shumë nga ato që kanë qenë në fund të vitit shkollor 2014/2015. Krahasuar me ekzemplarin e përdorur në pyetësin elektronik të vitit 2015, ekzemplari i këtij viti përfshin 11 shkolla më tepër: 1 shkollë të mesme dy-gjuhëshe dhe 10 shkolla një-gjuhëshe (9 shkolla fillore+1 shkollë të mesme).

Për qëllimet e këtij hulumtimi, komunat janë klasifikuar si homogjene ose heterogjene, varësisht prej pranisë së një ose më shumë gjuhë mësimore². Kështu, në qoftë se të gjitha shkollat (fillore ose të mesme) në komunë janë me një dhe të njëjtën gjuhë mësimore, komuna konsiderohet si homogjene. Nga ana tjetër, në qoftë se janë së paku dy gjuhë mësimore brenda të njëjtës komunë, komuna konsiderohet si heterogjene. Kjo ndarje është më relevante për shkollat një-gjuhëshe, pasi që shkollat shumë-gjuhëshe, për nga vetë definimi janë të vendosura në komuna heterogjene.

Tabela A. tregon se pjesa më e madhe e shkollave janë të organizuara me një gjuhë mësimore. Dominimi i shkollave një-gjuhëshe në Maqedoni është evidente nëpër shkollat e mesme (66%), dhe madje edhe më e dukshme nëpër shkollat fillore (72%). Në anën tjetër, janë vetëm dy shkolla fillore në gjuhën turke; në të gjitha rastet tjera, Turqishtja si gjuhë mësimore ekziston vetëm në shkollat shumë-gjuhëshe (në 42% të shkollave fillore shumë-gjuhëshe dhe 37% të shkollave të mesme shumë-gjuhëshe). Rreth 75% të të gjitha shkollave shumë-gjuhëshe janë të kufizuara për nxënësit që mësojnë ose Maqedonisht ose Shqip. Maqedonishtja shfaqet si gjuhë mësimore në 97% të shkollave fillore dy/tre gjuhëshe dhe në të gjitha shkollat e mesme dy/tre gjuhëshe, ndërsa Shqipja përfaqësohet në 75% të shkollave fillore dhe në 87% të shkollave të mesme shumë-gjuhëshe. Gjuha Serbe është prezente vetëm në 3 dhe gjuha Boshnjake në 2 shkolla fillore dy/tre gjuhëshe, dhe të dyjat krejtësisht mungojnë në arsimimin e mesëm.

Tabela A. thekson faktin se më shumë se 60% të shkollave fillore dhe më pak se 25% të shkollave të mesme një-gjuhëshe janë të vendosura nëpër komuna heterogjene. Gjuha Maqedonase është gjuha e vetme në pjesën më të madhe të shkollave fillore dhe të mesme nga të dy llojet e komunave, por pjesa e shkollave fillore dhe të mesme në gjuhën Shqipe në mesin e shkollave një-gjuhëshe është më e madhe në kuadër të komunave heterogjene.

Tabela B. e shfaqur në faqen tjetër përmban të dhëna shtesë për shkollat shumë-gjuhëshe. Ajo përmbledh shpërndarjen e gjuhëve mësimore sipas përqindjes së nxënësve që ndjekin mësim në gjuhë të caktuar. Të dhënat tregojnë se shumica e shkollave dy-gjuhëshe janë të organizuara rreth një gjuhë mësimore shumë dominuese (ose Maqedonisht ose Shqip), ndërsa një çekuilibër të lehtë gjuhësor ekziston në shumicën e shkollave tre-gjuhëshe (kryesisht në favor të gjuhës Maqedonase). Shkollat me përfaqësim të balancuar të dy/tre gjuhëve mësimore janë kryesisht ata që ofrojnë mësim në gjuhën Maqedonase dhe Shqipe, ose Maqedonase, Shqipe dhe Turke.

² E njëjta komunë mund të klasifikohet si homogjene duke e marrë parasysh gjuhën mësimore që përdoret në shkollat e mesme, por poashtu edhe si heterogjene duke i marrë parasysh gjuhët mësimore që janë funksionale në shkollat fillore .

Tabela B. Përshkrim i hollësishëm i shkollave shumë-gjuhëshe të përfshira në hulumtim*

		Shkolla fillore	Shkolla të mesme	
Shkolla shumë-gjuhëshe	MAQ-ShQ	MSh e balancuar	6	2+4
		MSh e lehtë	5	2
		MSh ekstreme	17	8
		ShM e lehtë	7	1
		ShM ekstreme	14	2
			49	19
	MAQ-TUR	MT e balancuar	1	
		MT e lehtë	1	
		MT ekstreme	16	3
		TM ekstreme	2	1
			20	4
	MAQ-ShQ-TUR	MShT e balancuar	6	1
		MShT e lehtë	1	1
		ShTM ekstreme	1	
		TMSH e lehtë	2	
		ShMT e lehtë	4	4
		ShMT ekstreme	2	1
		16	7	
	MAQ-ShQ-SER	MShS e lehtë	1	
		1		
MAQ-SER	MS ekstreme	1		
	SM ekstreme	1		
		2		
TUR-ShQ	TSh ekstreme	2		
	ShT ekstreme	1		
		3		
MAQ-ShQ-BOSH	ShBM ekstreme	1		
	1			
MAQ-BOSH	BM ekstreme	1		
		1		
Gjithsej		93	30	

* Në shkollat shumë-gjuhëshe, renditja e gjuhëve mësimore është bërë në bazë të numrit të nxënësve: e *balancuar*-numri i balancuar i nxënësve (40-60%); e *lehtë* – gjuha e parë dominon lehtë (30-70%); *ekstreme*-gjuha e parë dominon jashtëzakonisht (mbi 70%)

Të dhënat nga Tabela C.1. tregojnë se vetëm 32% të nxënësve të shkollave fillore nga ekzemplari mësojnë në shkolla shumë-gjuhëshe³. Numri më i madh që mbetet i nxënësve nga shkollat fillore është nga shkollat fillore që janë të vendosura në komuna heterogjene (45% ndaj. 23% që janë të vendosura në komunat ku të gjitha shkollat fillore përdorin gjuhën e njëjtë mësimore). Krahasimet ndër-gjuhësore tregojnë se nxënësit e shkollave fillore që mësojnë në gjuhën Shqipe (31% të numrit të përgjithshëm të nxënësve të shkollave fillore) janë të shpërndarë thuajse në mënyrë të barabartë

³ Në krahasim me të dhënat e vitit të kaluar, këtë vit, numri i përgjithshëm i nxënësve të shkollave fillore në ekzemplarin e shkollave është më i vogël për diku rreth 3900, por shpërndarja e nxënësve mes shkollave shumë-gjuhëshe dhe një-gjuhëshe ka mbetur thuajse e pandryshuar.

mes shkollave një-gjuhëshe (parësisht nga komunat heterogjene) dhe atyre shumë-gjuhëshe (më shumë se gjysma e tyre janë nga shkollat me gjuhë Maqedonase-Shqipe). Tre të katërtat e nxënësve të shkollave fillore që mësojnë në gjuhën Maqedonase mësojnë në shkolla një-gjuhëshe (më shumë në komuna heterogjene se sa homogjene). Një pjesë e vogël e nxënësve të shkollave fillore mësojnë në gjuhën Turke, dhe një pjesë shumë e vogël në gjuhën Serbe dhe Boshnjake.

Tabela C.1. Shpërndarja e nxënësve të shkollave fillore sipas gjuhës mësimore

Nxënës të shkollave fillore	MAQ	ShQ	TUR	SER	BOSH	<i>gjithsej</i>
në shkollat shumë-gjuhëshe	24.663	26.891	4.985	115	311	56.965
MAQ-ShQ	12.595	15.741				28.336
MAQ-TUR	6.797		1.520			8.317
ShQ-TUR		1.138	1.051			2.189
MAQ-SER	37			81		118
MAQ-BOSH	37				150	187
MAQ-ShQ-TUR	5.025	8.307	2.414			15.746
MAQ-ShQ-SER	154	97		34		285
MAQ-ShQ-BOSH	18	1.608			161	1.787
% në kuadër të shkollave shumë-gjuhëshe	43,3	47,2	8,8	0,2	0,5	100
<i>% nga gjuha përkatëse</i>	21,1	47,6	87,8	99,1	100,3	31,7
në shkollat një-gjuhëshe	92.397	29.596	691			122.684
<i>% në kuadër të shkollave një-gjuhëshe</i>	75,3	24,1	0,6			100
<i>% nga gjuha përkatëse</i>	78,9	52,4	12,2			68,3
nga komunat homogjene	35.604	5.538				41.142
<i>% në kuadër të shkollave 1-gj. KHo</i>	86,5	13,5				100
<i>% nga gjuha përkatëse</i>	30,4	9,8				22,9
nga komunat heterogjene	56.793	24.058	691			81.542
<i>% në kuadër të shkollave 1-gj. KHe</i>	69,6	29,5	0,8			100
<i>% nga gjuha përkatëse</i>	48,5	42,6	12,2			45,4
<i>gjithsej</i>	117.059	56.488	5.676	116	310	179.649
<i>% nga gjuha përkatëse</i>	65,2	31,4	3,2	0,06	0,17	100

Analiza e të dhënave të paraqitura në Tabelën C.1 dhe C.2 zbulon se proporcioni i përgjithshëm mësimdhënës-nxënës në shkollat fillore shumë-gjuhëshe është 1:10,7 dhe në shkollat fillore një-gjuhëshe është 1:10,8. Krahasimi i mëtejshëm i numrave të fituara për arsimimin fillor tregon se proporcioni mësimdhënës-nxënës për gjuhën mësimore Turke është mbi mesataren e përgjithshme (1:12,6). Proporcioni për gjuhën mësimore Maqedonase është më i favorshëm në shkollat shumë-gjuhëshe (1:9) se sa në shkollat një-gjuhëshe (1:11,7), ndërsa proporcioni i njëjtë për gjuhën mësimore Shqipe është më i favorshëm për shkollat një-gjuhëshe (1:8,5) se sa për shkollat shumë-gjuhëshe (1:13). Kjo sjell në përfundim se, mesatarisht, më rehatshëm është të angazhohen në mënyrë plotësuese mësimdhënësit nga gjuha mësimore Maqedonase në shkollat fillore shumë-gjuhëshe dhe ato nga gjuha mësimore Shqipe në shkollat një-gjuhëshe.

Tabela C.2. Shpërndarja e mësimdhënësve të shkollave fillore sipas gjuhës mësimore

Mësimdhënës të shkollave fillore	MAQ	ShQ	TUR	SER	BOSH	<i>gjithsej</i>
në shkollat shumë-gjuhëshe	2.751	2.071	386	28	21	5.257
MAQ-ShQ	1.393	1.211				2.604
MAQ-TUR	847	0	106			953
ShQ-TUR		110	74			184
MAQ-SER	19	0	0	21		40
MAQ-BOSH	16	0	0	0	4	20
MAQ-ShQ-TUR	452	639	206			1.297
MAQ-ShQ-SER	18	18	0	7		43
MAQ-ShQ-BOSH	6	93	0	0	17	116
<i>% në kuadër të shkollave shumë-gjuhëshe</i>	52,3	39,4	7,3	0,5	0,4	100
<i>% nga gjuha përkatëse</i>	25,9	37,3	85,4	100,0	100,0	31,5
në shkollat një-gjuhëshe	7.888	3.475	65			11.428
<i>% në kuadër të shkollave një-gjuhëshe</i>	69,0	30,4	0,6			100
<i>% nga gjuha përkatëse</i>	74,1	62,7	14,4			68,5
nga komunat homogjene	3.247	538				3.785
<i>% në kuadër të shkollave 1-gj. KHo</i>	85,8	14,2				100
<i>% nga gjuha përkatëse</i>	30,5	9,7				22,7
nga komunat heterogjene	4.641	2.937	65			7.643
<i>% në kuadër të shkollave 1-gj. KHe</i>	60,7	38,4	0,9			100
<i>% nga gjuha përkatëse</i>	43,6	53,0	14,4			45,8
<i>gjithsej</i>	10.638	5.545	452	28	21	16.684
<i>% nga gjuha përkatëse</i>	63,8	33,2	2,7	0,17	0,13	100

Tabela D.1⁴ tregon se një numër më i madh i nxënësve prej shkollave të mesme mësojnë në shkolla një-gjuhëshe (kryesisht nëpër komuna me një gjuhë mësimore) sesa nëpër shkolla shumë-gjuhëshe (kryesisht shkolla në gjuhë Maqedonase-Shqipe). Pjesa më e madhe e nxënësve të shkollave të mesme që ndjekin mësim në gjuhën Maqedonase mësojnë në shkolla një-gjuhëshe të vendosura në komuna homogjene, ndërsa nxënësit e shkollave të mesme nga gjuha Shqipe mësimore me pjesëmarrje të njëjtë janë regjistruar në shkollat shumë-gjuhëshe. Të gjithë nxënësit e shkollave të mesme që mësojnë në gjuhën Turke shkojnë në shkolla shumë-gjuhëshe.

Proporcioni mesatar mësimdhënës-nxënës për shkollat e mesme (Tabela D.2. krahasuar me Tabelën D.1) është shumë më i favorshëm për shkollat shumë-gjuhëshe (1:6) sesa që është për shkollat një-gjuhëshe (1:11,7). Kjo është për shkak të proporcionit shumë të ulët që vlen për klasat e gjuhës Maqedonase të shkollave shumë-gjuhëshe (1:5 krahasuar me 1:10,8 për klasat në gjuhën Shqipe). Proporcioni mësimdhënës-nxënës për shkollat një-gjuhëshe është përsëri më i favorshëm për shkollat e gjuhës Maqedonase (1:11,4) sesa që është për shkollat e gjuhës Shqipe (1:13,7). Pra, mesatarisht, mësimdhënësit e shkollave të mesme shumë-gjuhëshe (veçanërisht nga gjuha mësimore

⁴ Në krahasim me të dhënat prej vitit të kaluar, këtë vit, numri i përgjithshëm i nxënësve të shkollave të mesme që mësojnë në gjuhën Shqipe është 11% më i lartë; për nxënësit që mësojnë në gjuhën Maqedonase ai është 2% më i ulët, dhe për ato që mësojnë në gjuhën Turke numri i tyre është 27% më i ulët. Dallimi i përgjithshëm mes dy ekzemplarëve të shkollave është rreth 500 nxënës në favor të këtij viti.

Maqedonase) janë më tepër në dispozicion për aktivitete plotësuese në krahasim me kolegët e tyre nga shkollat një-gjuhëshe (veçanërisht ata që ligjërojnë në gjuhën Shqipe).

Tabela D.1. Shpërndarja e nxënësve të shkollave të mesme sipas gjuhës mësimore

Nxënës të shkollave të mesme	MAQ	ShQ	TUR	Gjithsej
në shkolla shumë-gjuhëshe	14.130	12.569	986	27.685
MAQ-ShQ	10.749	8.403		19.152
MAQ-TUR	1.556		403	1.959
MAQ-ShQ-TUR	1.825	4.166	583	6.574
% në kuadër të shkollave shumë-gjuhëshe	51,0	45,4	3,6	100
% nga gjuha përkatëse	31,7	67,0	100,0	43,0
në shkolla një-gjuhëshe	30.482	6.187		36.669
% në kuadër të shkollave një-gjuhëshe	83,1	16,9		100
% nga gjuha përkatëse	68,3	33,0		57,0
nga komuna homogjene	23.058	1.161		24.219
% në kuadër të shkollave 1-gj. KHo	95,2	4,8		100
% nga gjuha përkatëse	51,7	6,2		37,6
nga komunat heterogjene	7.424	5.026		12.450
% në kuadër të shkollave 1-gj. KHe	59,6	40,4		100
% nga gjuha përkatëse	16,6	26,8		19,3
gjithsej	44.612	18.756	986	64.354
% nga gjuha përkatëse	69,3	29,1	1,5	100

Tabela D.2. Shpërndarja e mësimdhënësve të shkollave të mesme sipas gjuhës mësimore

Mësimdhënës të shkollave të mesme	MAQ	ShQ	TUR	gjithsej
në shkolla shumë-gjuhëshe	2.816	1.161	367	4.343
MAQ-ShQ	1.249	773		2.022
MAQ-TUR	1.287	0	308	1.595
MAQ-ShQ-TUR	280	388	59	726
% në kuadër të shkollave shumë-gjuhëshe	64,8	26,7	8,5	100
% nga gjuha përkatëse	51,2	72,0	100,0	58,1
në shkolla një-gjuhëshe	2.685	452		3.137
% në kuadër të shkollave një-gjuhëshe	85,6	14,4		100
% nga gjuha përkatëse	48,8	28,0		41,9
nga komuna homogjene	2.100	92		2.192
% në kuadër të shkollave 1-gj. KHo	95,8	4,2		100
% nga gjuha përkatëse	38,2	5,7		29,3
nga komuna heterogjene	585	360		945
% në kuadër të shkollave 1-gj. KHe	61,9	38,1		100
% nga gjuha përkatëse	10,6	22,3		12,6
gjithsej	5.501	1.613	367	7.480
% nga gjuha përkatëse	73,5	21,6	4,9	100

Të dhënat në Tabelën E. zbulojnë se 78,5% nga numri i përgjithshëm i 93 shkollave fillore shumë-gjuhëshe kanë njësi rajonale. Gjysma e tyre (49%) kanë më shumë se një gjuhë mësimore në njësi qendrore, dhe gjysma tjetër (51%) janë shkolla shumë-gjuhëshe vetëm për shkak se njësitë e tyre rajonale sigurojnë mësim në gjuhë të ndryshme nga ajo e përfaqësuar në njësinë qendrore. Kjo tregon se gjysma e shkollave fillore nuk ofrojnë ndërveprim ndër-gjuhësor në bazë ditore, dhe më tepër veprojnë si shkolla një-gjuhëshe sesa si shkolla dy/tre gjuhëshe.⁵

Tabela E. Shkollat fillore shumë-gjuhëshe me njësi rajonale⁶

<i>Gjuhët mësimore në shkollë</i>	<i>me 2/3 gjuhë mësimore në shkollën qendrore</i>	<i>me një gjuhë mësimore në shkollën qendrore</i>	<i>gjithsej</i>
MAQ-ShQ	15	20	35
MAQ-TUR	6	14	20
ShQ-TUR	1	1	2
MAQ-SER	1	1	2
MAQ-ShQ-TUR	11	1	12
MAQ-ShQ-SER	1		1
MAQ-ShQ-BOSH	1		1
gjithsej	36	37	73

Tabela F. Shkollat fillore shumë-gjuhëshe me gjuhë të ndryshme mësimore në njësinë e njëjtë organizative që dallojnë sipas asaj se vallë ofrohen gjuhët e përfaqësuar në të gjitha vitet shkollore

<i>Gjuhët mësimore në shkollë</i>	<i>ME 2/3 gjuhë mësimore në të gjitha vitet shkollore</i>			<i>PA 2/3 gjuhë mësimore në të gjitha vitet shkollore</i>			GJITHSEJ
	shkolla pa njësi rajonale	shkolla qendrore (pa njësitë e tyre rajonale)	<i>gjithsej</i>	shkolla pa njësi rajonale	shkolla qendrore (pa njësitë e tyre rajonale)	<i>gjithsej</i>	
MAQ-ShQ	11	14	25 (51%)	3	21	24 (49%)	49
MAQ-TUR		2	2 (10%)		18	18 (90%)	20
SHQ-TUR		1		1	1	2 (66,7%)	3
MAQ-SER		1	1 (33,3%)		1	1 (50%)	2
MAQ-ShQ-TUR	4	10	14 (87,5%)		2	2 (12,5%)	16
MAQ-ShQ-SER					1	1 (100%)	1
MAQ-ShQ-BOSH		1	1 (100%)				1
MAQ-BOSH	1		1 (100%)				1
Gjithsej	16	29	45 (48,4%)	4	44	48 (51,6%)	93

⁵ Vitin e kaluar ka pasur më shumë shkolla fillore shumë-gjuhëshe me vetëm një gjuhë mësimore në shkollën qendrore (71% nga 75).

⁶ Janë vetëm tre shkolla të mesme dy-gjuhëshe (Maqedonisht/Shqip) që kanë njësi rajonale, dhe në njërin prej tyre të dyja gjuhët mësimore janë të pranishme në shkollën qendrore, ndërsa në dy prej tyre nxënësit në shkollën qendrore mësojnë në një gjuhë.

Analiza e mëtejshme e shkollave fillore shumë-gjuhëshe (Tabela F.) tregon se pak më shumë se gjysma e këtyre shkollave nuk ofrojnë mësim në të gjitha gjuhët mësimore gjatë gjithë viteve shkollore – ata funksionojnë si shkolla dy-gjuhëshe vetëm në vitet e para shkollore (në nivel të arsimit fillor) dhe vazhdojnë si shkolla një-gjuhëshe në të gjitha vitet tjera shkollore. Kjo vlen pothuajse për të gjitha shkollat fillore të gjuhës Maqedonase-Turke, si dhe për gjysmën e shkollave fillore Maqedonase-Shqipe. Kjo më tutje zvogëlon mundësinë e bashkëpunimit të përditshëm ndërmjet mësimitdhënësve dhe nxënësve nga gjuhë të ndryshme.⁷

Tabela G. Organizimi i mësimimit në shkollat shumë-gjuhëshe nëpër objekte (për ato që kanë njësi rajonale vetëm për objektet qendrore)

Gjuhët mësimore në shkollë	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej	
	2/3 objekte	një objekt	gji-thsej	2/3 objekte	një objekt	gji-thsej	2/3 objekte	një objekt
MAQ-ShQ	12	37	49	5	14	19	17	51
MAQ-TUR	3	17	20	1	3	4	4	20
ShQ-TUR	1	2	3				1	2
MAQ-SER		2	2				0	2
MAQ-ShQ-TUR	7	9	16	3	4	7	10	13
MAQ-ShQ-SER	1		1				1	0
MAQ-ShQ-BOSH		1	1				0	1
MAQ-BOSH		1	1				0	1
Gjithsej	24 (26%)	69 (74%)	93	9 (30%)	21 (70%)	30	33	90

Kur është fjala për organizimin e hapësirës së procesit mësimor në shkollat shumë-gjuhëshe (Tabela G.), të dhënat tregojnë se në shumicën e shkollave fillore dhe të mesme, nxënësit nga të gjithë gjuhët mësimore mësojnë në një objekt. Ekzistojnë akoma shkolla shumë-gjuhëshe që funksionojnë në më shumë se një objekt. Në 13 nga gjithsej 24 shkolla fillore dhe 4 nga gjithsej 9 shkolla të mesme të këtij lloji, të gjitha gjuhët mësimore janë të përfaqësuara në të gjitha objektet shkollore, ndërsa në 4 (nga 24) shkolla fillore dhe 3 (nga 9) shkolla të mesme, nxënësit janë të ndarë në objekte të ndryshme sipas gjuhës mësimore. Mes shkollave tjera shumë-gjuhëshe me 2/3 objekte ekzistojnë disa variacione: në një/dy objekte nxënësit janë të “përzier” ndërsa në objektet tjera të gjithë nxënësit mësojnë në një gjuhë të njëjtë (p.sh. MAQ-ShQ në një dhe vetëm ShQ në tjetër), ose kemi edhe kombinim të ndryshëm të gjuhëve të përfaqësuara në objekte të ndryshme (p.sh. MAQ-ShQ në një dhe ShQ-TUR në tjetër).

Kur bëhet fjalë për organizimin e kohës së zhvillimit të mësimimit në shkollat shumë-gjuhëshe (Tabela H.), është e dukshme se në shumicën e shkollave fillore dhe madje edhe në më shumë nga shkollat e mesme, nxënësit ndjekin mësim në dy ose tri ndërrime. Në 35 nga 66 shkolla fillore shumë-gjuhëshe dhe në 15 prej 26 shkollave të mesme shumë-gjuhëshe me më shumë se një ndërrim, nxënësit nga të gjithë gjuhët mësimore mësojnë në ndërrime të “përziera”, ndërsa në vetëm 15/5 të këtyre shkollave

⁷Të dhënat nga hulumtimi i vitit të kaluar tregojnë se 62% nga gjithsej 93 shkolla fillore shumë-gjuhëshe nuk kanë të gjitha gjuhët mësimore të përfaqësuara në të gjitha vitet shkollore.

(fillore/të mesme), ndërrimet janë të përcaktuara sipas linjës gjuhësore . Në pjesën tjetër të shkollave, njëri ndërrim është homogjen ndërsa ndërrimi tjetër është i “përzier”.

Tabela H. Organizimi i mësimi në aspekt të ndërrimeve në shkollat shumë-gjuhëshe

Gjuhët mësimore në shkollë	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej	
	2/3 ndërrime	një ndërrim	<i>gjithsej</i>	2/3 ndërrime	një ndërrim	<i>gjithsej</i>	2/3 ndërrime	një ndërrim
MAQ-ShQ	38	11	49	17	2	19	55	13
MAQ-TUR	10	10	20	3	1	4	13	11
ShQ-TUR	3		3			0	3	0
MAQ-SER	1	1	2			0	1	1
MAQ-ShQ-TUR	12	4	16	6	1	7	18	5
MAQ-ShQ-SER	1		1			0	1	0
MAQ-ShQ-BOSH	1		1			0	1	0
MAQ-BOSH		1	1			0	0	1
<i>Gjithsej</i>	66 <i>(71%)</i>	27 <i>(29%)</i>	93	26 <i>(87%)</i>	4 <i>(13%)</i>	30	92	31

Prej 93 shkollave fillore shumë-gjuhëshe, vetëm 22 ofrojnë mësim të gjuhës shqipe si lëndë zgjedhore për nxënësit që nuk mësojnë në shqip, kurse asnjë prej shkollave një-gjuhëshe. Gjithsej 1635 nxënës marrin pjesë nëpër këto klasa; ku 84% prej tyre janë nga klasat me gjuhë mësimore Maqedonase.

REZULTATE

Raporti nga hulumtimi elektronik bazohet në krahasimet mes shkollave me dy/tre gjuhë mësimore dhe shkollave me një gjuhë mësimore kryesisht të klasifikuara në dy kategori: shkollat një-gjuhëshe nga komunat heterogjene dhe shkollat një-gjuhëshe nga komunat homogjene. Në kuadër të secilës nga këto kategori janë bërë krahasime shtesë mes shkollave fillore dhe të mesme.

Kur rezultatet e fituara kanë të bëjnë me situatën në shumicën e shkollave, atëherë ato janë të prezantuar me ndihmë të përqindjeve qoftë në grafikone ose në tabela; kur rezultatet kanë të bëjnë me numër të kufizuar të shkollave, ato janë të paraqitur si numra në tabela dhe/ose në tekst.

Rezultatet e fituara janë të grupuar në katër pjesë që synojnë dhënien e përgjigjeve për tre pyetjet në vijim:

1. Vallë shkollat sigurojnë kushte për realizimin e aktiviteteve PINA?
2. Vallë shkollat kanë realizuar aktivitete PINA? Në cilat fusha këto aktivitete janë realizuar në mënyrë më të suksesshme?
3. Si e vlerësojnë shkollat ndikimin e realizimit të aktiviteteve PINA?

Pas analizës së të dhënave të fituara nga hulumtimi elektronik, rezultatet tregojnë që ka mundësi që shkollat të kenë raportuar aktivitete të përbashkëta që në të vërtetë nuk kanë ndodhur, qoftë si pasojë e paqartësisë së llojeve të aktiviteteve të shënuara në pyetësor, ose nga nevoja për të prezantuar që ata kanë bërë më shumë, kryesisht me qëllim për ta manifestuar përkushtimin e tyre ndaj integrimit ndëretnik në arsim. Me qëllim për ti verifikuar informatat e marra nga shkollat mbi aktivitetet e përbashkëta, ekipi i ekspertëve të CHRRCR-së në bashkëpunim me anëtarët e MASH-it vizituan një ekzemplar të shkollave dhe biseduan me anëtarët e SIT-it rreth realizimit të aktiviteteve.

Ekzemplari për verifikim përbëhet prej 12 shkollave në vijim, nga dy prej secilës kategori të shkollave fillore dhe të mesme:

	Shkolla fillore, komuna (gjuha)	Shkolla të mesme, komuna (gjuha)
KHo një-gjuhëshe	Kultura, Likovë (Sh) H. T. Karposh, Rankovcë (M)	Sv. Kliment Ohridski, Ohri (M) Ismet Jashari, Likovë (Sh)
KHe një-gjuhëshe	Vuk Karagjiq, Kumanovë (M) Forina, Gostivari (Sh)	Sami Frasheri, Kumanovë (Sh) Jovçe Tesliçkov, Veles (M)
Shumë-gjuhëshe	Panajot Ginoski, k.Butel, Shkup (MSh) Kiril Pejçinoviç, Tearce (MShT)	Dr. Ibrahim Temo, Strugë (MShT) Dimitar Vllahov, Shkup (MShT)

Shkollat nga ekzemplari për verifikim janë vizituar në Shtator të vitit 2016. Gjatë vizitave, prej SIT-ave është kërkuar ti përshkruajnë aktivitetet e realizuar dhe të tregojnë fakte për realizimin e tyre me qëllim që ti ndihmojnë ekipit të projektit të kuptojë se çfarë dhe si është bërë në të vërtetë. Rezultatet e fituara janë prezantuar në pika përkatëse të raportit dhe janë hijezuar me të verdhë (ashtu siç është bërë në këtë pjesë).

Sigurimi i kushteve për realizimin e aktiviteteve PINA

Ekipet për integrim shkollor (SIT)

Vetëm 12 shkolla (shkolla-fillore: 1MT+5M+2SH; shkolla të mesme: 1MSH+1M+1Sh+1MSHT) përgjigjën që nuk kanë formuar Ekipet për integrim shkollor (SIT), por sidoqoftë, gjysma e tyre kanë pasur ose individë ose shërbime profesionale që kanë koordinuar dhe kanë realizuar aktivitete PINA.

Tabela 1.1. Aktivitetet PINA të realizuar nga SIT-at e shkollave (nga shkollat që kanë formuar SIT)

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej (403)
	KHo një-gjuh. (gjith.80)	KHe një-gjuh. (gjith.147)	shumë- gjuh. (gjith.92)	KHo një-gjuh. (gjith.42)	KHe një-gjuh. (gjith.14)	shumë- gjuh. (gjith.28)	
Pjesëmarrja në trajnime në nivel shkollor	78 (97,5%)	140 (95,2%)	84 (91,3%)	36 (85,7%)	14 (100%)	28 (100%)	380 (94,3%)
Përgatitja e planeve të veprimit për futjen e aktiviteteve PINA në planin vjetor të shkollës	75 (93,8%)	129 (87,7%)	83 (90,2%)	34 (80,9%)	10 (71,4%)	24 (85,7%)	355 (88,1%)
Koordinimi dhe monitorimi i realizimit të aktiviteteve të planifikuara	75 (93,8%)	115 (78,2%)	78 (84,8%)	33 (78,6%)	10 (71,4%)	23 (82,1%)	334 (82,9%)
Koordinimi dhe organizimi i aktiviteteve për zhvillim të vazhdueshëm profesional të kuadrit shkollor	42 (52,5%)	73 (49,6%)	45 (48,9%)	20 (47,6%)	4 (28,6%)	12 (42,8%)	196 (48,6%)
Mbajtja e vetë-evaluimit të shkollës për aktivitetet e realizuara	52 (65%)	94 (63,9%)	61 (66,3%)	23 (54,8%)	9 (64,3%)	18 (64,3%)	257 (63,8%)
Planifikimi i aktiviteteve PINA	75 (93,8%)	123 (83,7%)	80 (86,9%)	32 (76,2%)	11 (78,6%)	25 (89,3%)	346 (85,8%)
Koordinimi dhe pjesëmarrja në aktivitetet me shkollën/at partnere	53 (66,3%)	105 (71,4%)	61 (66,3%)	27 (64,3%)	7 (50%)	17 (60,7%)	270 (67%)
Inicimi dhe koordinimi i aktiviteteve për kyçjen e prindërve në këto aktivitete	59 (73,8%)	94 (63,9%)	73 (79,3%)	26 (61,9%)	6 (42,8%)	15 (53,6%)	273 (67,7%)
Sigurimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me palët e interesuar në komunë dhe/ose BZHA	42 (52,5%)	80 (54,4%)	50 (54,3%)	22 (52,4%)	5 (35,7%)	15 (53,6%)	214 (53,1%)
Realizimi i aktiviteteve në bashkëpunim me kryesinë e shkollës	33 (41,3%)	69 (46,9%)	50 (54,3%)	19 (45,2%)	5 (35,7%)	14 (50%)	190 (47,1%)
Gjithsej	584	1.022	665	272	81	191	2.815

Kur janë pyetur se cilat aktivitete PINA janë realizuar nga SIT-at ekzistues (Tabela 1.1.), thuajse të gjitha shkollat kanë përgjigjur se kanë marrë pjesë në trajnim në nivel shkollor dhe një shumicë e madhe e shkollave (mbi 80%) janë përgjigjur se kanë qenë të përfshirë në futjen e aktiviteteve PINA në Planin vjetor të shkollës, planifikimin e këtyre aktiviteteve dhe koordinimin dhe monitorimin e

realizimit të tyre. Në pjesën më të vogël të shkollave (pak ndër 50%), SIT-at janë përballuar me aktivitete të përbashkëta profesionale dhe kanë bashkëpunuar me Kryesinë shkollore në lidhje me aktivitetet PINA.

Trajnim për aktivitetet INA

Tabela 1.2.1.

Shkollat e përfaqësuara në trajnimet për aktivitete INA në 4/5 vitet e fundit

	Shkolla fillore (ShF)	Shkolla të mesme(ShM)
KHo një-gjuhëshe	78 (92,9%)	41 (93,2%)
KHe një-gjuhëshe	139 (92,7%)	13 (92,9%)
Shumë-gjuhëshe	84 (90,3)	28 (93,3%)

Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 1.2.1, thuajse të gjitha shkollat (përmes përfaqësuesve të tyre) kanë marrë pjesë në të paktën një trajnim të PINA-s gjatë 4/5 viteve të fundit. Njëmbëdhjetë shkolla shumë-gjuhëshe (9 ShF+2 ShM) dhe 21 shkolla një-gjuhëshe (17 ShF+4 ShM) nuk kanë qenë të kyçur në trajnimet, kryesisht për shkak se (ashtu siç thonë) nuk kanë qenë të informuar rreth mundësive për trajnim. Vetëm tetë prej tyre (3 shumë-gjuh. + 5 një-gjuh.) thonë se nuk kanë nevojë për trajnim, dhe prej shkollave tjera ka shumë që thonë se i tërë kuadri shkollor ka nevojë që të trajnohet (7 shumë.gjuh. + 10 një-gjuh.) dhe më pak (1 shumë.gjuh. + 6 një-gjuh.) që besojnë se trajnimi është i nevojshëm vetëm për mësime të interesuar.

Tabela 1.2.2. Përkatesia etnike e pjesëmarrësve në trajnimet PINA (numri i pjesëmarrësve nga secili grup etnik i shoqëruar nga numri i shkollave prej të cilave janë ato)


			MAQ	ShQ	TUR	SER	ROM	VLLE	BOSh	tjetër	gjithsej
Shkolla fillore	KHo një-gjuh.	kuadri	1.608	0	150	0	0	0	0	0	1.758
		shkollat	70	3	8	0	0	2	2	0	85
	KHe një-gjuh.	kuadri	2.394	0	445	43	0	0	0	0	2.882
		shkollat	108	20	41	12	3	7	2	7	200
	Shumë-gjuh.	kuadri	1.285	10	759	164	0	0	3	0	2.221
		shkollat	77	7	60	37	2	4	10	0	197
Shkolla të mesme	KHo një-gjuh.	kuadri	1.109	0	40	0	0	0	0	0	1.149
		shkollat	39	4	2	3	0	4	1	1	54
	KHe një-gjuh.	kuadri	408	0	27	0	0	0	0	0	435
		shkollat	39	4	2	3	0	4	1	1	54
	Shumë-gjuh.	kuadri	812	0	573	52	0	0	0	0	1.437
		shkollat	27	3	23	10	1	0	0	0	64
gjithsej	kuadri	7.616	1.994	10	259	0	0	3	0	9.882	
	shkollat	360	136	41	65	6	21	16	9	654	
%	Nga kuadri		77,1	20,2	0,1	2,6	0,0	0,0	0,0	0,0	100
	Nga shkollat		55,0	20,8	6,3	9,9	0,9	3,2	2,4	1,4	100

Sipas shkollave, gjithsej 9.882 pjesëmarrës kanë marrë pjesë në trajnime të PINA-s. Siç ka qenë edhe e pritur, shumica e pjesëmarrësve (82%) janë mësime të interesuar, dhe të tjerët janë: personel nga shërbimi profesional (548), anëtarë të udhëheqësisë shkollore (459) dhe anëtarë të kryesisë shkollore (773). 69,4% të pjesëmarrësve në trajnimet janë nga shkollat fillore dhe 30,6% nga shkollat

e mesme. 63% nga to punojnë në shkolla një-gjuhëshe dhe 37% në shkolla shumë-gjuhëshe. Mes tyre, pjesëmarrësit femra janë shumë më të përfaqësuara (68%) se sa pjesëmarrësit meshkuj (32%). Përfaqësimi i femrave është akoma më i lartë mes pjesëmarrësve nga shkollat fillore (71%) se sa mes pjesëmarrësve nga shkollat e mesme (62%).

Përkatësia etnike e pjesëmarrësve në trajnimet është paraqitur në mënyrë të hollësishmen në Tabelën 1.2.2. Si përfundim, 77% të pjesëmarrësve janë Maqedonas etnik që vijnë 55% nga shkollat pjesëmarrëse dhe 20% janë Shqiptarë etnik, që vijnë nga 21% të shkollave pjesëmarrëse. Proporcioni mes pjesëmarrësve nga këto dy grupe etnike nuk korrespondon me pjesën e përgjithshme të kuadrit shkollor.

Grafikoni 1.2 tregon se shumica e shkollave (pak më shumë prej shkollave fillore se sa të mesme) i shohin trajnimet e PINA-s si të dobishme për më shumë se 60% të punonjësve të tyre. Me fjalë tjera, trajnimet kanë kontribuar për shumicën e kuadrove shkollore për ta kuptuar më mirë dhe për ta pranuar nevojiten e integritimit ndëretnik në arsim.



Grafikoni 1.2. Dobishmëria e trajnimit për INA për kuadrin shkollor (nga shkollat me kuadër të trajnuar)

Nga 301 shkollat fillore që kanë marrë pjesë në trajnimet për INA, vetëm 26% (18 shumë-gjuh.+59 një-gjuh.) besojnë se kuadri i tyre nuk ka nevojë për trajnim shtesë. Mendimi i njëjtë është ndarë edhe nga 41% të shkollave të mesme (25 shumë-gjuh.+9 një-gjuh.). Akoma, shumica e shkollave (më shumë prej shkollave fillore se sa të mesme) deklarojnë se kuadri i tyre i punësuar tani dhe/ose mësimdhënësit e interesuar do të kishin dashur të kenë trajnim shtesë.


Dokumentet shkollore

Mes 89-95% të shkollave kanë deklaruar se misioni/vizioni i tyre është përshtatur dhe është reflektuar në përkushtimin e shkollës për integrimin ndëretnik në arsim. Sidoqoftë, siç paraqet Tabela 1.3., evaluimi i misioneve dhe vizioneve aktuale të shkollave tregon se këto përqindje janë më të ulëta, por akoma konfirmojnë se shumica e shkollave nga të gjitha kategoritë e kanë shprehur përkushtimin e tyre ndaj aktiviteteve INA në misionet/vizionet e tyre.

Tabela 1.3.
Shkollat që kanë përshtatur vizionin/misionin e tyre për ta reflektuar përkushtimin e tyre ndaj aktiviteteve INA

	Shkolla fillore	Shkolla të mesme
KHo një-gjuhëshe	57 (67,9%)	33 (75%)
KHe një-gjuhëshe	99 (66%)	9 (64,3%)
Shumë-gjuhëshe	61 (65,6%)	20 (66,7%)

Thuajse të gjitha shkollat (97% të shkollave fillore një-gjuhëshe dhe 97% të shkollave fillore shumë-gjuhëshe; 88% të shkollave të mesme një-gjuhëshe dhe 93% të shkollave të mesme shumë-gjuhëshe) kanë raportuar se kanë përfshirë aktivitete PINA në Planet e tyre vjetore shkollore. Grafikoni 1.3. tregon se shumica e këtyre shkollave kanë përfshirë aktivitete PINA në mënyrë të drejtpërdrejtë në planet e tyre, ndërsa pjesa tjetër kanë përgatitur shtojcë zyrtare në planet e tyre. Përfshirja e drejtpërdrejtë e aktiviteteve PINA në Planet vjetore shkollore është më e shpeshtë te shkollat e mesme se sa te shkollat fillore.



Grafikoni 1.3. Si janë të përfshira aktivitetet PINA në Planin vjetor shkollor (nga shkollat që kanë përfshirë aktivitete PINA)

Këshilli i shkollës

Shumica e shkollave shumë-gjuhëshe (74,2% prej shkollave fillore dhe 76,7% prej shkollave të mesme) kanë anëtarë nga të gjitha bashkësitë etnike të përfaqësuar në Këshillin e tyre. Supozohet se Këshilli i shkollës në këto shkolla është më i ndjeshëm ndaj nevojës për aktivitetet për integrim ndëretnik se sa Këshilli i shkollave shumë-gjuhësh që në të vërtetë funksionojnë si trupa një-gjuhësh.

Është interesante për të theksuar se më shumë meshkuj se sa femra marrin pjesë në anëtarësinë e Kryesive shkollore (76% ndaj 24%). Ky raport është 75%:25% në shkollat fillore dhe 77%:23% në shkollat e mesme. Sidoqoftë, proporcioni në kuadër të të gjitha shkollave shumë-gjuhëshe është më pak në favor të anëtarëve meshkuj (60%:40%) dhe akoma më pak (52%:48%) mes shkollave një-gjuhëshe, kryesisht për shkak se shkollat fillore një-gjuhëshe nga komunat homogjene janë përjashtim (54% të anëtarëve janë femra).


Të dhënat nga Tabela 1.4 demonstrojnë se mesatarja e përfaqësimit etnik të Shqiptarëve në këshillat shkollor (25%) është më e vogël se sa pjesa e nxënësve që mësojnë në Shqip në kuadër të numrit të përgjithshëm të nxënësve (rreth 30%), ndërsa mesatarja e përfaqësimit etnik të Turqve (3%)

reflekton pjesën e nxënësve që mësojnë në Turqisht. Kështu, përfaqësimi i përgjithshëm i të gjithë etnitetëve tjera duke përfshirë edhe atë Maqedonas është pak më i lartë se sa pjesa e nxënësve që mësojnë në gjuhën Maqedonase.

Tabela 1.4. Përkatësia etnike e anëtarëve të Këshillit shkollor

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej
	KHo një-gjuh.	KHe një-gjuh.	Shumë-gjuh.	KHo një-gjuh.	KHe një-gjuh.	Shumë-gjuh.	
MAQ	754	948	439	454	104	212	2.911
ShQ	153	420	288	35	46	103	1.045
TUR	1	26	79	3	1	22	132
ROM	6	9	6	1			22
SER	4	23	12	2	4	6	51
VLIE	0	1	2	6			9
BOSh	0	6	17	1			24
tjetër	0	23	5	5		2	35
Gjithsej	918	1.456	848	507	155	345	4.229

Kur janë pyetur se vallë anëtarët e Këshillit shkollor janë të njoftuar me aktivitetet PINA, thuajse të gjitha shkollat (99% të shkollave një-gjuhëshe dhe 98% të shkollave shumë-gjuhëshe) kanë dhënë përgjigje pohuese. Rezultatet në Grafikonin 1.4. tregojnë se në të shumtën e rasteve Këshilli shkollor është i informuar rreth aktiviteteve PINA. Njëkohësisht, ka edhe anëtarë të këshillave që kanë mësuar rreth PINA-s përmes pjesëmarrjes së tyre në aktivitete ose trajnimet. Më shumë nga shkollat fillore se sa të mesme njoftojnë se anëtarët e këshillave të tyre kanë marrë pjesë në aktivitetet PINA.



Grafikoni 1.4.

Sa janë të informuara Këshillat e shkollave rreth aktiviteteve PINA (përqindjet nga shkollat që kanë përcjellë informata deri te Këshillat e tyre)


Këshilli prindëror

Nga 10.259 prindër që kanë marrë pjesë në Këshillat prindërore, 53% janë meshkuj dhe 47% janë femra. Dallimi në favor të meshkujve është më i vogël në shkollat fillore (52%-48%) se sa në shkollat e mesme (56%-44%). Vetëm në shkollat një-gjuhëshe dallimi është pak më shumë në favor të femrave (49% meshkuj/51% femra) për shkak të përbërjes gjinore të kryesive të shkollave një-gjuhëshe të vendosura në komunat homogjene, ndërsa në shkollat shumë-gjuhëshe përfaqësimi i meshkujve është më i lartë (61%meshkuj ndaj 39% femra).

Tabela 1.5. Përkatësia etnike e anëtarëve të Këshillave prindërore

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej
	KHo një-gjuh.	KHe një-gjuh.	shumë-gjuh.	KHo një-gjuh.	KHe një-gjuh.	shumë-gjuh.	
MAQ	1.833	2.548	1.300	420	177	386	6.664
ShQ	283	975	950	13	47	295	2.563
TUR	13	87	283	7	2	44	436
ROM	30	163	38	6	2	10	249
SER	8	55	24	1	10	6	104
VLIE	2	6	8	3	0	0	19
BOSh	8	15	65	1	1	8	98
të tjerë	2	84	32	5	0	3	126
Meshkuj	922	2.053	1.647	237	115	462	5.436
Femra	1.257	1.880	1.053	219	124	290	4.823
Gjithsej	2.179	3.933	2.700	456	239	752	10.259

Të dhënat prej Tabelës 1.5 tregojnë se përqindja e përgjithshme e prindërve etnik Shqiptarë (25%) është nën pjesën e nxënësve nga gjuha mësimore Shqipe në numrin e përgjithshëm të nxënësve, kurse pjesa e prindërve Maqedonas etnik është më e lartë (65%) se sa pjesa e nxënësve që mësojnë në gjuhën mësimore Maqedonase, posaçërisht duke e pasur parasysh që shumica e nxënësve nga bashkësitë etnike që janë pakicë mësojnë në gjuhën Maqedonase.



Grafikoni 1.5.

Sa janë të përfshirë anëtarët e Këshillave prindërore në aktivitetet PINA (nga shkollat që kanë përfshirë Këshille prindërore në aktivitete PINA)

Akoma më shumë shkolla të mesme (89% prej shkollave fillore 93% prej shkollave të mesme) kanë Këshill prindëror me anëtarë nga të gjitha bashkësitë gjuhësore të përfaqësuara në shkollë. Një përqindje e lartë e shkollave (88% të shkollave fillore dhe 73% të shkollave të mesme) kanë arritur të sigurojnë bashkëpunim me Këshillat prindërore rreth aktiviteteve PINA. Ashtu siç është paraqitur në Grafikonin 1.5, më shumë prej shkollave shumë-gjuhëshe kanë përfshirë anëtarë të këshillave në planifikimin dhe pjesëmarrjen në aktivitetet INA se sa në inicimin e këtij lloji të aktiviteteve. Inicimi i aktiviteteve poashtu ka qenë formë më pak e përfaqësuar e bashkëpunimit me prindër në të gjitha shkollat një-gjuhëshe, përveç në shkollat e mesme nga komunat heterogjene.

Partneritetet

Numri i përgjithshëm i shkollave që kanë formuar partneritet me shkollë tjetër/shkolla tjera shkon deri 78% (nga numri i përgjithshëm i 415 shkollave). Tabela 1.6.1 demonstroi se përqindja më e lartë e shkollave që kanë formuar partneritet/e i përket kategorisë së shkollave një-gjuhëshe të vendosura në komunat heterogjene që plotësisht korrespondon me nevojat dhe mundësitë. Njëkohësisht, shkollat shumë-gjuhëshe (që në rastet e shumta vetë mund të realizojnë aktivitete PINA) u shërbejnë shkollave një-gjuhëshe si mundësi e përshtatshme për partneritet/e (më shumë mes shkollave fillore se sa mes shkollave të mesme). Në krahasim me të dhënat nga hulumtimi i vitit 2014/15, përqindja e shkollave që kanë formuar partneritete është rritur, posaçërisht mes shkollave fillore një-gjuhëshe nga komunat homogjene (nga 70% deri 80%) dhe shkollave të mesme një-gjuhëshe prej komunave heterogjene (nga 75% deri 86%).

Tabela 1.6.1.
Shkollat që kanë formuar partneritet me shkollë tjetër/shkolla tjera në kuadër të PINA-s

	Shkolla fillore	Shkolla të mesme
KHo njëgjuh.	67 (79,8%)	29 (65,9%)
KHe njëgjuh.	129 (86%)	12 (85,7%)
Shumë-gjuh.	71 (76,3%)	16 (53,5%)

Ekzistojnë shkolla që kanë formuar më shumë se një partneritet. Kjo bëhet e dukshme kur të dhënat nga Tabela 1.6.2. krahasohen me të dhënat nga Tabela 1.6.1: Gjithsej 364 partneritete janë shfaqur nga përfshirja e 267 shkollave fillore, dhe 81 partneritete janë arritur nga pjesëmarrja e 57 shkollave të mesme. Mes shkollave fillore, pjesa më e madhe në numrin e përgjithshëm të partneriteteve u përket shkollave një-gjuhëshe nga komunat heterogjene, kurse mes shkollave të mesme, shkollat një-gjuhëshe nga komunat heterogjene marrin pjesë me pjesën më të vogël (Tabela 1.6.2.). Kjo më shumë ose më pak e reflekton shpërndarjen e shkollave në kuadër të ekzemplarit të përgjithshëm.

Tabela 1.6.2.
Partneritetet e formuara në kuadër të PINA-s

	Mes shkollave fillore	Mes shkollave të mesme
KHo njëgjuh.	76 (20,9%)	31 (38,3%)
KHe njëgjuh.	163 (44,8%)	23 (28,4%)
Shumë-gjuh.	125 (34,3%)	27 (33,3%)

Analiza e mëtejshme e numrit të partneriteteve të formuara sjell deri te rezultatet e prezantuara në Tabelën 1.6.3. Kjo tregon se më shumë se gjysma e të gjitha shkollave në vend (57,1%) kanë krijuar marrëdhënie partnerike vetëm me një shkollë, por akoma ka një pjesë të vogël të shkollave (më shumë prej shkollave fillore se sa të mesme) që kanë 3-5 partneritete (5% të të gjitha shkollave). Është interesant se këto partneritete përfshijnë më së shumti shkolla shumë-gjuhëshe, që në të vërtetë nuk kanë nevojë për partneritete për të realizuar aktivitete të përbashkëta.

Tabela 1.6.3. Shkollat me partneritete të formuara ndaj numrit të partneriteteve të formuara

		Shkolla fillore (327)	% nga kategoria përkatëse e shkollave	Shkolla të mesme (88)	% nga kategoria përkatëse e shkollave	Numri i përgjithshëm i shkollave me partneritete
me 1	KHo një-gjuh.	59	70,2	27	61,4	237
	KHe një-gjuh.	99	66,0	7	50,0	
	Shumë-gjuh.	36	38,7	9	30,0	
me 2	KHo një-gjuh.	7	8,3	2	4,5	66
	KHe një-gjuh.	28	18,7	3	21,4	
	Shumë-gjuh.	22	23,7	4	13,3	
me 3-5	KHo një-gjuh.	1	1,2			21
	KHe një-gjuh.	2	1,3	2	14,3	
	Shumë-gjuh.	13	14,0	3	10,0	

Tabela 1.6.4 përshkruan shkollat që kanë mbetur pa partneritet, sipas gjuhës së tyre mësimore. Në fakt, 22 shkolla fillore dhe 14 shkolla të mesme shumë-gjuhëshe nuk kanë nevojë për partneritet që të realizojnë aktivitete të përbashkëta PINA. Sidoqoftë, 38 shkollat fillore dhe 17 shkollat e mesme një-gjuhëshe nuk mund të mbajnë aktivitete të përbashkëta pa hyrë në partneritet me ndonjë shkollë me gjuhë tjetër mësimore. Shumica e tyre janë shkolla me gjuhë Maqedonase; janë vetëm katër shkolla fillore dhe një shkollë e mesme një-gjuhëshe që nuk kanë formuar partneritet.

Tabela 1.6.4.
Shkollat pa partneritet

		Shkolla fillore	Shkolla të mesme
KHo një-gjuhëshe	MAQ	16	14
	ShQ	1	1
KHe një-gjuhëshe	MAQ	18	2
	ShQ	3	
Shumë-gjuhëshe	MAQ-ShQ	9	7
	MAQ-TUR	6	3
	MAQ-ShQ-TUR	6	4
	MAQ-ShQ-SER	1	

Shkaqet kryesore se pse shkollat nuk janë angazhuar në partneritet/e dallojnë sipas kategorisë së shkollave (Tabela 1.6.5). Për thuajse të gjitha shkollat e mesme shumë-gjuhëshe dhe për shumicën e shkollave fillore shumë-gjuhëshe është fakti se ata nuk kanë nevojë për partneritet që të realizojnë aktivitete PINA. Thuajse gjysma e shkollave fillore një-gjuhëshe nga komunat heterogjene konsiderojnë se largësia fizike prej partnerëve potencial është barriera më e madhe, kurse gjysma e kategorive tjera të shkollave i fajësojnë shkollat potenciale partnere për mungesën e vullnetit për bashkëpunim. Gjysma tjetër e shkollave të mesme një-gjuhëshe nga komunat heterogjene si pengesë kryesore theksojnë mungesën e kohës. Rezultatet tregojnë se mbështetja financiare (edhe për

shkollat edhe për mësimdhënësit) është përmendur si faktor i madh nga një përqindje të konsiderueshme të shkollave.

Tabela 1.6.5. Shkaqet për mungesën e partneritetit (shkollat pa partneritet)

	Shkolla filllore			Shkolla të mesme			Gjithsej (91)
	KHo një-gjuh. (17)	KHe një-gjuh. (21)	shumë-gjuh. (22)	KHo një-gjuh. (15)	KHe një-gjuh. (2)	shumë-gjuh. (14)	
Mungesa e vullnetit për bashkëpunim mes shkollave potenciale partnere	10 (58,8%)	6 (28,6%)	3 (13,6%)	7 (46,7%)	1 (50%)	1 (7,1%)	28 (30,8%)
Mungesa e kohës për bashkëpunim me shkollë partnere		2 (9,5%)		1 (6,7%)	1 (50%)		4 (4,4%)
Mungesa e mbështetjes financiare për bashkëpunim	1 (5,9%)	3 (14,3%)		3 (20%)			7 (7,7%)
Mungesa e stimulit financiar për mësimdhënësit	1 (5,9%)		2 (9,1%)	1 (6,7%)			4 (4,4%)
Largësia fizike me shkollat potenciale partnere	5 (29,4%)	10 (47,6%)		3 (20%)			18 (19,8%)
Shkolla jonë është shumë-gjuhëshe – nuk kemi nevojë për partneritet me shkollë tjetër			17 (77,3%)	0 (0)		13 (92,9%)	30 (33%)

Realizimi i përgjithshëm i aktiviteteve INA në shkollat

Tabela 2.1.1.
Shkollat që kanë realizuar aktivitete INA në partneritet (viti shkollor 2015/2016)

		Shkolla filllore	Shkolla të mesme
Nga të gjitha shkollat	KHo një-gjuhëshe	56 (66,7%)	16 (36,4%)
	KHe një-gjuhëshe	102 (68%)	8 (57,1%)
	Shumë-gjuhëshe	54 (58,1%)	12 (40%)
Nga shkollat me partneritet/e	KHo një-gjuhëshe	56 (83,6%)	16 (55,2%)
	KHe një-gjuhëshe	102 (79,1%)	8 (66,7%)
	Shumë-gjuhëshe	54 (76,1%)	12 (75%)

Pjesa e parë e Tabelës 2.1.1. (nga të gjitha shkollat) demonstroi se një pjesë më e madhe e shkollave filllore se sa atyre të mesme ka arritur të realizojë aktivitete të përbashkëta INA me shkollën/shkollat e tyre partnere vitin shkollor 2015/2016. Përfundimi i njëjtë është arritur edhe nga të dhënat e fituara nga hulumtimi i vitit 2014/15, por krahasimi i kryqëzuar në bazë të viteve tregon një tendencë të zvogëlimit të angazhimit të shkollave në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me shkollën/at partnere. Te shkollat filllore, kjo vlen posaçërisht për shkollat shumë-gjuhëshe (ajo që ka qenë më parë 73% tani ka rënë në 58%) dhe për shkollat një-gjuhëshe nga komunat heterogjene (nga 80% në 68%); te shkollat e mesme rënia është më e dukshme për shkollat një-gjuhëshe nga komunat homogjene (nga 54% në 36%).

Pjesa e dytë e Tabelës 2.1.1 (nga shkollat me partneritet/e) zbulon se ekzistojnë akoma shumë partneritete të formuara, posaçërisht mes shkollave të mesme por që nuk funksionojnë. Edhe përpos


asaj që ka më shumë partneritete të formuara në vitin 2015/16 në krahasim me vitin shkollor paraprak, definitivisht ka më pak partneritete që funksionojnë. Përqindja e shkollave fillore me partneritete të formuara që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta ka rënë për 9-24% (ka qenë 93% për shkollat një-gjuhëshe dhe 100% për shkollat shumë-gjuhëshe); për shkollat e mesme rënia më e rëndësishme është për shkollat një-gjuhëshe në komunat homogjene (nga 85% në 55%) dhe shkollat shumë-gjuhëshe (nga 93% në 75%).

Tabela 2.1.2. Shkaqet për mungesën e partneriteteve aktive (shkollat me partneritet/e të formuar/a, por pa realizim të aktiviteteve të përbashkëta në të gjitha partneritetet e tyre ose në disa nga to)

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej (114)
	KHo një-gjuh. (15)	KHe një-gjuh. (38)	shumë- gjuh. (30)	KHo një-gjuh. (14)	KHe një-gjuh. (7)	shumë- gjuh. (10)	
Mungesa e vullnetit të mësimdhënësve për tu angazhuar në aktivitetet e përbashkëta		2 (5,3%)		1 (7,1%)			3 (2,6%)
Mungesa e vullnetit të shkollës/ave partnere për bashkëpunim	2 (13,3%)	7 (18,4%)	2 (6,7%)	1 (7,1%)	1 (14,3%)		13 (11,4%)
Mungesa e kohës për bashkëpunim me shkollën partnere	3 (20%)	6 (15,8%)	3 (10%)	1 (7,1%)	1 (14,3%)	1 (10%)	15 (13,2%)
Mungesa e mbështetjes financiare për bashkëpunim	7 (46,7%)	21 (55,3%)	20 (66,7%)	10 (71,4%)	4 (57,1%)	8 (80%)	70 (61,4%)
Mungesa e stimulit për mësimdhënësit	2 (13,3%)	2 (5,3%)	5 (16,7%)	1 (7,1%)	1 (14,3%)	1 (10%)	12 (10,5%)
Zgjedhja e papërshtatshme e shkollës partnere	1 (6,7%)						1 (0,9%)

Kur janë pyetur se pse nuk kanë realizuar aktivitete PINA me shkollën/at e tyre partnere (Tabela 2.1.2.), shumica e shkollave (duke përfshirë shkollat fillore dhe të mesme si dhe një-gjuhëshe dhe shumë-gjuhëshe) kanë përgjigjur se kjo është për shkak të kohëzgjatjes së shkurtë të mbështetjes financiare për bashkëpunim. Vetëm disa shkolla një-gjuhëshe kanë pranuar se shkak kryesor është mungesa e vullnetit të mësimdhënësve të tyre për të realizuar aktivitete të përbashkëta.

Grafikoni 2.1. ilustron se si shkollat me partneritete funksionale e kanë realizuar bashkëpunimin e tyre me shkollën/at partnere. Rezultatet e prezantuara tregojnë se thuajse të gjitha shkollat nga të tre kategoritë (edhe shkollat fillore edhe ato të mesme) kanë kushtuar vizita shkollës/ave të tyre partnere, dhe numri më i vogël i tyre e kanë reduktuar bashkëpunimin e tyre në kontakte vetëm mes mësimdhënësve. Njëkohësisht, kontaktet e tërthorta përmes mjeteve elektronike paraqiten si forma mjaft të shpeshta të bashkëpunimit, posaçërisht mes shkollave të mesme. Në të njëjtën kohë, takimet e rregullta paraqiten si më të shpeshta mes shkollave fillore një-gjuhëshe nga komunat heterogjene dhe më së paku prezente mes shkollave të mesme shumë-gjuhëshe.



Grafikoni 2.1.

Format e ndryshme të bashkëpunimit mes shkollave partnere (nga shkollat me partneritet/e aktiv/e)

Tabela 2.1.3. Raportet mes partneritetit/eve të formuar/a, aktiviteteve PINA të realizuara dhe aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve të realizuara gjatë vitit shkollor 2015/16

Shkolla me partneritete të formuara				Shkolla që kanë realizuar aktivitete PINA në partneritet				Shkolla që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta të nxënësve			
	Gjithsej	një	dy-tre		Gjithsej	një	dy-tre		Gjithsej	një	dy-tre
PO	324	238	86	PO	248	182	66	PO	243	179	64
				JO	76	56	20	JO	5	3	2
				PO	19	0	19	JO	57	56	1
JO	91	55	36					PO	35	0	35
								JO	56	55	1
Gjithsej	415	293	122		324	238	86		415	293	122
PO	324	238	86		248	182	66		297	179	118
JO	91	55	36		76	56	20		62	114	4

Tabela 2.1.3 përmban përmbledhje të të dhënave që e ilustronë situatën e përgjithshme lidhur me realizimin e aktiviteteve PINA në nivel shkollor. Kjo tregon se ka shkolla që nuk kanë formuar partneritetet dhe të tilla që edhe përpos asaj që kanë formuar partneritet/e nuk kanë realizuar aktivitete PINA, por kanë mbajtur aktivitete të përbashkëta me grupe “të përzier” të nxënësve në kuadër të shkollave të veta. Kjo është e mundshme të ndodhë në shkollat shumë-gjuhëshe dhe ndonjëherë në shkollat një-gjuhëshe me numër të konsiderueshëm të nxënësve nga pakicat etnike. Analiza e mëtejshme e të dhënave të fituara zbulon se 87% e shkollave me partneritet/e kanë

realizuar aktivitete PINA në vitet e më parshme (në krahasim me 76,5% për vitin e fundit shkollor 2015/16). 34 shkolla shtesë pa partneritet për vitin e fundit shkollor kanë pasur partneritet/e funksionale në vitet paraprake dhe 67 shkolla tjera që nuk kanë realizuar aktivitete PINA gjatë vitit aktual shkollor, kanë bërë këtë përmes partneritetit/eve funksional/e në vitet paraprake shkollore. 93% të shkollave që nuk kanë partneritet/e funksional/e gjatë vitit aktual shkollor deklarojnë që ata do ti vënë në funksion partneritetet në vitin e ardhshëm shkollor.

Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta me nxënës

Sipas të dhënave në Tabelën 3.1.1, aktivitetet e përbashkëta të nxënësve janë realizuar më shumë në shkolla fillore se sa të mesme. Në fakt, te shkollat fillore, ato janë realizuar kryesisht në shkollat e vendosura në komunitet heterogjene (edhe në shkollat një-gjuhëshe edhe në ato shumë-gjuhëshe), kurse te shkollat e mesme ato kanë qenë më së shumti të pranishëm në shkollat shumë-gjuhëshe.

Tabela 3.1.1.
Shkollat që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta me grupe “të përzier” të nxënësve (nga të gjitha shkollat)

	Shkolla fillore	Shkolla të mesme
KHo një-gjuhëshe	53 (16,2%)	16 (18,2%)
KHe një-gjuhëshe	102 (31,2%)	8 (9,1%)
Shumë-gjuhëshe	91 (27,8%)	27 (30,7%)

Tabela 3.1.2. tregon se më shumë aktivitete të përbashkëta me grupe “të përzier” të nxënësve janë realizuar në partneritet/e se sa në kuadër të shkollave. Ky dallim është më i dukshëm te shkollat fillore se sa të mesme. Sidoqoftë, te shkollat shumë-gjuhëshe, shumica e aktiviteteve të përbashkëta kanë përfshirë vetë nxënësit e tyre që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore.

Tabela 3.1.2.
Sa janë realizuar aktivitetet e përbashkëta të nxënësve (nga shkollat fillore/të mesme që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta me nxënës)


		Shkolla fillore (246)	Shkolla të mesme (51)
në partneritet	KHo një-gjuhëshe	53 (21,5%)	16 (31,4%)
	KHe një-gjuhëshe	102 (41,5%)	8 (15,7%)
	shumë-gjuhëshe	13 (5,3%)	0
në kuadër të shkollës	shumë-gjuhëshe	51 (20,7%)	19 (37,3%)
në të dyja mënyrat	shumë-gjuhëshe	27 (11,0%)	8 (15,7%)

Kur janë pyetur se vallë aktivitetet e përbashkëta me nxënës të realizuara në/nga shkollën/a e tyre i plotësojnë kërkesat për punë me grupe të balancuara për nga gjuha, shumica e shkollave një-gjuhëshe (mes 66%-75%) dhe më pak prej shkollave shumë-gjuhëshe (53% prej shkollave fillore dhe 44% prej shkollave të mesme) janë përgjigjur se të gjitha aktivitete e tyre të përbashkëta janë realizuar ashtu siç është kërkuar. Shumica e shkollave tjera thonë se një pjesë më e madhe e aktiviteteve të tyre të përbashkëta kanë qenë sipas kriterëve, dhe vetëm 5 shkolla një-gjuhëshe dhe 13 shumë-gjuhëshe kanë thënë se vetëm një pjesë më e vogël e aktiviteteve të tyre të përbashkëta kanë devijuar nga kriteret. Vetëm 4 shkolla shumë-gjuhëshe (2 ShF + 2 ShM) kanë thënë se thuajse të gjitha aktivitetet e përbashkëta me nxënësit e tyre janë realizuar në grupe të pa balancuara për nga gjuha.

Tabela 3.1.3. Shkaqet për mungesën e aktiviteteve të përbashkëta me nxënës (shkollat që nuk kanë realizuar kësi lloj aktiviteteve)

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej (118)
	KHo një-gjuh. (31)	KHe një-gjuh. (48)	shumë-gjuh. (2)	KHo një-gjuh. (28)	KHe një-gjuh. (6)	shumë-gjuh. (3)	
Mungesa e vullnetit të shkollës partnere për bashkëpunim	12 (38,7%)	11 (22,9%)		10 (35,7%)	1 (16,7%)	1 (33,3%)	35 (29,7%)
Mungesa e vullnetit të mësimdhënësve për angazhim në aktivitete të përbashkëta		2 (4,2%)	1 (50%)	1 (3,6%)			4 (3,4%)
Mungesa e kohës për bashkëpunim me shkollën partnere	4 (12,9%)	4 (8,3%)		3 (10,7%)	3 (50%)		14 (11,9%)
Mungesa e mbështetjes financiare për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta	7 (22,6%)	20 (41,7%)		10 (35,7%)	1 (16,7%)	1 (33,3%)	39 (33,1%)
Mungesa e stimulit financiar për mësimdhënësit	3 (9,7%)	1 (2,1%)	1 (50%)	1 (3,6%)	1 (16,7%)		7 (5,9%)
Zgjedhja e papërshtatshme e shkollës partnere						1 (33,3%)	1 (0,8%)
Distanca fizike me shkollën partnere	5 (16,1%)	10 (20,8%)		3 (10,7%)			18 (15,3%)

Ashtu siç paraqet Tabela 3,1,3, shkaqet për mungesën e aktiviteteve të përbashkëta me grupe “të përzier” të nxënësve ndryshojnë sipas kategorive të shkollave. Vetëm dy prej shkaqeve të dhëna në listë janë treguar nga shumica e shkollave që u përkasin tre kategorive të ndryshme dhe të dytë janë të jashtëm: njëri është mungesa e vullnetit të shkollës partnere për bashkëpunim dhe tjetri është mungesa e mbështetjes financiare për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta.


Grafikoni 3.1.

Llojet e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve të realizuara në partneritet dhe/ose në kuadër të shkollës (nga numri i përgjithshëm i aktiviteteve në kategorinë përkatëse të shkollave)

Rezultatet nga Grafikoni 3.1 zbulojnë se aktivitetet jashtë-mësimore me nxënës nga gjuhë të ndryshme mësimore kanë qenë më të famshme se sa aktivitetet mësimore, por gjysma e shkollave fillore që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta deklarojnë se ato kanë edhe aktivitete mësimore edhe aktivitete jashtë-mësimore. Njëkohësisht, gjysma e homologëve të tyre nga shkollat e mesme janë fokusuar vetëm në aktivitetet jashtë-mësimore.

Aktivitetet e përbashkëta jashtë-mësimore me nxënës

Tabela 3.2.1. Llojet e aktiviteteve të përbashkëta jashtë-mësimore me nxënës, të realizuar në partneritetet dhe/ose në kuadër të shkollës (nga shkollat që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta)

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej (266)
	KHo një-gjuh. (46)	KHe një-gjuh. (92)	shumë-gjuh. (83)	KHo një-gjuh. (14)	KHe një-gjuh. (8)	shumë-gjuh. (23)	
shëtitje	17 (37%)	41 (44,6%)	55 (66,3%)	4 (28,6%)	4 (50%)	15 (65,2%)	136 (51,1%)
vizita	33 (71,7%)	71 (77,2%)	52 (62,7%)	12 (85,7%)	5 (62,5%)	9 (39,1%)	182 (68,4%)
shfaqje	25 (54,3%)	53 (57,6%)	65 (78,3%)	9 (64,3%)	3 (37,5%)	15 (65,2%)	170 (63,9%)
matura	2 (4,3%)	6 (6,5%)	24 (28,9%)	0	0	9 (39,1%)	41 (15,4%)
kretime/ akt. shoqërore	6 (13%)	12 (13%)	16 (19,3%)	2 (14,3%)	1 (12,5%)	3 (13,0%)	40 (15%)
aksione ekologjike	10 (21,7%)	29 (31,5%)	58 (69,9%)	2 (14,3%)	1 (12,5%)	14 (60,9%)	114 (42,9%)
aktivitete në bashkësinë lokale	4 (8,7%)	13 (14,1%)	36 (43,4%)	1 (7,1%)	0	10 (43,5%)	64 (24,1%)
aktivitete multikulturore	32 (69,6%)	62 (67,4%)	64 (77,1%)	7 (50%)	4 (50%)	17 (73,9%)	186 (69,9%)
aktivitete të lira të nxënësve	19 (41,3%)	43 (46,7%)	52 (62,7%)	7 (50%)	4 (50%)	11 (47,8%)	136 (51,1%)
ngjarje sportive	27 (58,7%)	55 (59,8%)	64 (77,1%)	6 (42,9%)	3 (37,5%)	13 (56,5%)	168 (63,2%)
aktivitete humanitare	0	7 (7,6%)	28 (33,7%)	0	0	10 (43,5%)	45 (16,9%)
punëtori multikulturore	7 (15,2%)	20 (21,7%)	30 (36,1%)	1 (7,1%)	2 (25%)	8 (34,8%)	68 (25,6%)
seksione	10 (21,7%)	26 (28,3%)	36 (43,4%)	1 (7,1%)	0	8 (34,8%)	81 (30,5%)
ekipe sportive	19 (41,3%)	44 (47,8%)	46 (55,4%)	4 (28,6%)	5 (62,5%)	14 (60,9%)	132 (49,6%)
Gjithsej	211	482	626	56	32	156	1563

Tabela 3.2.1 ilustron aktivitetet e përbashkëta jashtë-mësimore me nxënës në ekzemplarin e shkollave që raportojnë se i kanë realizuar. Sipas të dhënave të prezantuara, vizitat e përbashkëta, aktivitetet multikulturore, ngjarjet sportive dhe shfaqjet kanë qenë të pranishëm në shumicën e shkollave fillore (mbi 55%), ndërsa aksionet ekologjike, shëtitjet dhe aktivitetet e lira të nxënësve janë realizuar vetëm në shumicën e shkollave fillore shumë-gjuhëshe. Në përgjithësi, numra të

ngjashme janë fituar edhe për shkollat e mesme shumë-gjuhëshe që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore, ndërsa numrat nga pjesa e vogël e shkollave të mesme një-gjuhëshe në këtë ekzemplar nuk janë konzistente. Prej aktiviteteve afatgjate jashtë-mësimore (punëtori multikulturore, seksione dhe ekipe sportive), vetëm ngjarjet e përbashkëta sportive janë raportuar se ekzistojnë në më shumë se gjysmën e shkollave shumë-gjuhëshe nga ky ekzemplar (edhe fillore edhe të mesme) dhe në shkollat e mesme një-gjuhëshe nga komunat heterogjene.

Analiza e mëtejshme e realizimit të aktiviteteve të përbashkëta jashtë-mësimore me nxënës e bazuar në përqindjet e marra nga numri i përgjithshëm i aktiviteteve në kuadër të kategorisë përkatëse të shkollave tregon se vizitat e përbashkëta janë më së shumti të përfaqësuara (së paku 15%) mes të gjitha aktiviteteve që janë realizuar në shkollat një-gjuhëshe (edhe fillore edhe të mesme), ndërsa nuk ka aktivitete që është po aq tipik për shkollat shumë-gjuhëshe.

Tabela 3.2.2. zbulon se numrat mesatarë të takimeve të përkushtuar ndaj aktiviteteve të përbashkëta jashtë-mësimore janë më të lartë në shkollat shumë-gjuhëshe (edhe fillore edhe të mesme) kur nxënësit-pjesëmarrës vijnë nga gjuhë të ndryshme mësimore në kuadër të shkollës ashtu siç është e pritur. Te shkollat një-gjuhëshe, numri mesatar i takimeve është më i lartë për shkollat e vendosura në komunat heterogjene se sa për ato në komunat homogjene. Sidoqoftë, numri mesatar i takimeve të shkollave një-gjuhëshe të realizuara në partneritet është mjaftë i lartë edhe për shkollat fillore edhe për ato të mesme.

Tabela 3.2.2.

		Shkolla fillore	Shkolla të mesme	
Numrat (dhe mesataret) e takimeve të realizuara për aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore me nxënës	KHo një-gjuh.	në partneritet	151 (3,5)	47 (3,4)
	KHe një-gjuh.	në partneritet	517 (5,7)	55 (6,9)
	shumë-gjuh.	në partneritet	176 (4,8)	21 (2,6)
		në kuadër të shkollës	725 (9,9)	234 (10,2)

Gjithsej 16.974 nxënës kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore me nxënës. 50,6% prej tyre janë vajza kurse 49,4% janë djem. Balanci në bazë gjinore është anashkaluar në shkollat fillore dhe të mesme një-gjuhëshe dhe shumë-gjuhëshe.

Tabela 3.2.3.

Nxënësit nga gjuhë të ndryshme mësimore që kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore (nga numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në shkollat fillore/të mesme)

		Shkolla fillore (221)	Shkolla të mesme (45)
MAQ	një-gjuh.	4.556 (83,1%)	647 (87,4%)
	shumë-gjuh.	3.855 (48,8%)	1.523 (53,3%)
ShQ	një-gjuh.	910 (16,6%)	93 (12,6%)
	shumë-gjuh.	2.934 (37,2%)	1.132 (39,6%)
TUR	një-gjuh.	16 (0,3%)	
	shumë-gjuh.	958 (12,1%)	204 (7,1%)
SER	një-gjuh.		
	shumë-gjuh.	36 (0,5%)	
BOSh	një-gjuh.		
	shumë-gjuh.	110 (1,4%)	
Gjithsej	një-gjuh.	5.482	740
	shumë-gjuh.	7.893	2.859

Sipas Tabelës 3.2.3, 83%/49% prej të gjithë nxënësve-pjesëmarrës nga shkollat një-gjuhëshe (filllore/të mesme) dhe 87%/53% prej të gjithë nxënësve-pjesëmarrës nga shkollat shumë-gjuhëshe (filllore/të mesme) janë nga gjuha mësimore Maqedonase. Të marrë në numra të përgjithshëm, nxënësit-pjesëmarrës që mësojnë në gjuhën Maqedonase mbulojnë 63%/60% të numrit të përgjithshëm të nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitete jashtë-mësimore në shkollat filllore/të mesme. Nëse supozohet se numrat e deklaruar janë të saktë, përfundohet se shumica e grupeve “të përziera” janë dominuar nga nxënësit që mësojnë në gjuhën Maqedonase.

Prej numrit të përgjithshëm të 3.549 mësimdhënësve që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore, 64% janë femra dhe 36% meshkuj. Proporcion të ngjashëm gjinor haset po ashtu edhe te mësimdhënësit-realizues nga të gjithë kategoritë e shkollave filllore dhe të mesme.

Tabela 3.2.4.
Mësimdhënësit nga gjuhë të ndryshme mësimore që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore me nxënës (nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të përfshirë nga shkollat filllore/të mesme)

		Shkolla filllore (221)	Shkolla të mesme (45)
MAQ	një-gjuh.	1.112 (80,3%)	135 (78,5%)
	shumë-gjuh.	781 (51,8%)	278 (57,4%)
ShQ	një-gjuh.	269 (19,4%)	37 (21,5%)
	shumë-gjuh.	549 (36,4%)	183 (37,8%)
TUR	një-gjuh.	4 (0,3%)	
	shumë-gjuh.	162 (10,7%)	23 (4,8%)
SER	një-gjuh.		
	shumë-gjuh.	12 (0,8%)	
BOSh	një-gjuh.		
	shumë-gjuh.	4 (0,3%)	
Gjithsej	një-gjuh.	1.385	172
	shumë-gjuh.	1508	484

Tabela 3.2.4 tregon se mësimdhënësit nga gjuha mësimore Maqedonase në përgjithësi janë të stërpërfaqësuar mes mësimdhënësve që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore me nxënës (Gjithsej 65%). Ata përbëjnë 65% të mësimdhënësve të shkollave filllore dhe 63% të mësimdhënësve të shkollave të mesme. Balanci gjuhësor ekziston mes mësimdhënësve nga shkollat shumë-gjuhëshe (me 53% të mësimdhënësve MAQ), ndërsa jobalanci më i lartë është paraqitur te mësimdhënësit e shkollave një-gjuhëshe (me 80% të MAQ). Këta numra mund të jenë produkt i përfshirjes së përsëritur të mësimdhënësve të njëjtë të gjuhëve të ndryshme mësimore (posaçërisht nga gjuha Shqipe) në më shumë se një aktivitet të përbashkët jashtë-mësimor me nxënës, ose përfshirje të mbi numëruar të mësimdhënësve nga gjuha mësimore Maqedonase në realizimin e këtyre aktiviteteve.

Tabela 3.2.5 paraqet se në përgjithësi, rreth 10% të nxënësve (edhe prej shkollave filllore edhe prej atyre të mesme) që mësojnë në gjuhën Maqedonase ose Shqipe janë përfshirë në aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore. Përqindja e mësimdhënësve-pjesëmarrës që ligjërojnë në këto dy gjuhë është më e lartë (më shumë te mësimdhënësit e shkollave filllore-se sa të mesme), edhe pse ato bien në rang në mes të 17-27%.

Tabela 3.2.5.

Pjesa e mësimdhënësve/nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore që kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore me nxënës (nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve/nxënësve në shkollat që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore)

		Shkolla fillore (221)	Shkolla të mesme (45)
MAQ	nxënës	8.411 (11,4%)	2.170 (9,1%)
	mësimdhënës	1.893 (27%)	413 (17%)
ShQ	nxënës	3.844 (9,1%)	1.225 (9,7%)
	mësimdhënës	818 (24%)	220 (19%)
TUR	nxënës	974 (19,7%)	204 (26,3%)
	mësimdhënës	166 (42,3%)	23 (32,7%)
SER	nxënës	36 (31,1%)	
	mësimdhënës	12 (43,2%)	
BOSH	nxënës	110 (35,4%)	
	mësimdhënës	4 (18,7%)	
Gjithsej	nxënës	13.375 (11%)	3.599 (9,6%)
	mësimdhënës	2.893 (26,6%)	656 (17,9%)

Rezultatet nga vizitat për verifikim tregojnë se:

- Shkollat definojnë vetëm të vizituarit e shkollës partnere si vizitë, përderisa aktivitetet në kuadër të vizitave të organizuara janë renditur veçmas si shtesë, pa marrë parasysh se vallë ato janë realizuar me grup të njëjtë nxënësish ose me grupe të ndryshme. Në të vërtetë, vizitat përfshijnë aktivitete të përbashkëta që realizohen me grup të njëjtë nxënësish ose janë të ndarë në grupe të ndryshme shumë të vogla (me ose pa aktivitet hyrës/përmbyllës të përbashkët me pjesëmarrje të të gjithë nxënësve që e përbëjnë grupin “e përzier” origjinal).
- Shkollat nuk bëjnë dallim mes aktiviteteve multikulturore, punëtorive multikulturore dhe të ashtuquajturave aktivitete autonome multikulturore – si përfundim, shkollat shpesh zgjedhin të tri llojet kur është fjala për njërin nga këto aktivitete dhe kështu që aktiviteti i njëjtë llogaritet tri herë. Në vend se të nënkuptojnë aktivitete me përmbajtje multikulturore që janë realizuar në rrethana një-gjuhësore, punëtoritë e pavarura “multikulturore” më së shumti kanë të bëjnë me realizimin e punëtorive nga programi për Arsimin e shkathtësive jetësore (i cili normalisht nuk ka përmbajtje multikulturore) ose me përfshirjen e përmbajtjeve multikulturore në orët e rregullta.
- Kur shkollat deklarojnë se kanë ekipe të përzier sportive, ata gjegjësisht e kanë për organizimin e aktiviteteve afat-shkurte sportive me ekipe “të përzier”. Ekipe reale “të përzieria” sportive që ushtrojnë rregullisht gjatë vitit shkollor thuhet se mungojnë tërësisht. Kjo vlen po ashtu edhe për shkollat shumë-gjuhëshe, edhe pse shumica nga këta shkolla deklarojnë se orët e edukatës fizike janë mbajtur bashkërisht (në hapësirë dhe kohë të njëjtë).
- Kur shkollat raportojnë se kanë seksione të përbashkëta afat-gjate, nuk ka fakte në shkollë që mund ta vërtetojnë këtë deklaratë.
- Në përgjithësi, shëtitjet e shënuara të përbashkëta janë realizuar sipas kriterëve të kërkuara.
- Numri i nxënësve dhe mësimdhënësve që janë raportuar në pyetësorët se kanë qenë të përfshirë në aktivitete dallojnë nga ato që janë raportuar gjatë vizitave për verifikim, edhe pse nuk ka rregulla për këta numra se kur janë më të ulte ose kur më të larta.
- Në aktivitete partnere një-gjuhëshe, zakonisht është respektuar balanci gjuhësor në grupet e “përzier”, por në shkollat shumë-gjuhëshe të shumtat e aktiviteteve janë me numër të jobalancuar të nxënësve (zakonisht përfshihet e tërë klasa dhe dominimi i gjuhës varet nga numri i nxënësve).

- Asnjë shkollë nuk ka dokument të shkruar që përmban numrin e takimeve të përbashkëta të realizuara, dhe nuk ka pajtueshmëri të përbashkët në atë se çfarë duhet të llogaritet si takim veçmas.

Aktivitetet e përbashkëta mësimore me nxënës

Rezultatet e dhëna në Tabelën 3.3.1 tregojnë se lloji më i përhapur i aktiviteteve mësimore mes shkollave një-gjuhëshe dhe shumë-gjuhëshe janë aktivitetet e ndryshme afat-shkurte që bëjnë pjesë në orët e rregullta mësimore. Një përqindje e vogël e shkollave fillore kanë raportuar se ata kanë realizuar orë në natyrë e cila paraqet formë të aktivitetit afat-gjatë. Aktivitetet mësimore afat-gjate (që do të realizohen si lëndë të rregullta zgjedhore) janë raportuar se do të realizohen në të shumtën e shkollave të mesme që kanë pasur aktivitete të përbashkëta mësimore.

Tabela 3.3.1. Llojet e aktiviteteve të përbashkëta mësimore me nxënës të realizuar në partneritet dhe/ose në kuadër të shkollës (nga shkollat që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta)

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej (179)
	KHo një-gjuh. (28)	KHe një-gjuh. (59)	shumë-gjuh. (67)	KHo një-gjuh. (10)	KHe një-gjuh. (2)	shumë-gjuh. (13)	
Aktivitete në kuadër të mësimit të rregullt	18 (64,3%)	41 (69,5%)	58 (86,6%)	5 (50%)	2 (100%)	13 (100%)	137 (76,5%)
Projekte në lëndë të rregullta	19 (67,9%)	39 (66,1%)	41 (61,2%)	7 (70%)		5 (38,5%)	111 (62,0%)
Orë në natyrë (në shkollat fillore)	4 (14,3%)	9 (15,3%)	19 (28,4%)				32 (17,9%)
Aktivitete projektuese (në shkollat e mesme)				5 (50%)	1 (50%)	6 (46,2%)	12 (6,7%)
Orë të lira (në shkollat profesionale)				3 (30%)	1 (50%)	1 (7,7%)	5 (2,8%)
Orë praktike (në shkollat profesionale)				3 (30%)		1 (7,7%)	4 (2,2%)
Gjithsej	41	89	118	23	4	26	301

Tabela 3.3.2 paraqet se ka pasur më pak takime në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta mësimore me nxënës se sa në kuadër të atyre jashtë-mësimore. Të dhënat e prezantuara tregojnë se numrat mesatar të takimeve për aktivitetet e përbashkëta mësimore me nxënës janë më të lartë për shkollat shumë-gjuhëshe se sa për shkollat një-gjuhëshe, dhe konfirmojnë pritjet se aktivitetet e përbashkëta mësimore janë më të realizueshme në shkollat ku ka gjuhë të ndryshme mësimore, se sa mes shkollave që kanë nga një gjuhë mësimore.

Tabela 3.3.2.		Shkolla fillore	Shkolla të mesme
Numrat (dhe mesataret) e takimeve të realizuara për aktivitetet e përbashkëta mësimore me nxënës	KHo një-gjuh.	Në partneritet	65 (2,4)
	KHo një-gjuh.	Në partneritet	352 (6,0)
	shumë-gjuh.	Në partneritet	102 (3,4)
		Në kuadër të shkollës	479 (8,1)
			26 (2,6)
			3 (1,5)
			7 (2,3)
			108 (8,3)

Gjithsej 7341 nxënës nga 154 shkolla fillore dhe 2203 nxënës nga 25 shkolla të mesme kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta. Në përgjithësi, nxënësit-pjesëmarrës kanë qenë mjaft të balancuar.

Jobalancë të vetme mund të gjendet mes nxënësve të shkollave të mesme, ku 54% të pjesëmarrësve kanë qenë djem. Krahasimet në aspekt gjinor mes mësimdhënësve tregojnë se prej 1485 mësimdhënësve të përfshirë, 63,5% janë femra dhe 36,5% meshkuj. Raport i ngjashëm vlen edhe për mësimdhënësit nga shkollat një-gjuhëshe dhe ata shumë-gjuhëshe, si dhe mësimdhënësit nga shkollat fillore. Vetëm te mësimdhënësit e shkollave të mesme jobalanca gjinore është dukshëm më e ulët (58,5% femra ndaj 41,5% meshkuj).

Tabela 3.3.3.

Nxënësit nga gjuhë të ndryshme mësimore që kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta mësimore me nxënës (nga numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në shkollat fillore/të mesme)

		Shkolla fillore (154)	Shkolla të mesme (25)
MAQ	një-gjuh.	2.440 (81,2%)	397 (88%)
	shumë-gjuh.	2.137 (49,3%)	942 (53,8%)
ShQ	një-gjuh.	559 (18,6%)	54 (12%)
	shumë-gjuh.	1.553 (35,8%)	764 (43,6%)
TUR	një-gjuh.	6 (0,2%)	0
	shumë-gjuh.	514 (11,9%)	46 (2,6%)
SER	një-gjuh.	0	0
	shumë-gjuh.	18 (0,4%)	0
BOSh	një-gjuh.	0	0
	shumë-gjuh.	114 (2,6%)	0
Gjithsej	një-gjuh.	3.005	451
	shumë-gjuh.	4.336	1.752

Sipas Tabelës 3.3.3, 81%/88% prej të gjithë nxënësve-pjesëmarrës në aktivitetet e përbashkëta mësimore nga shkollat një-gjuhëshe (fillore/të mesme) dhe 49%/54% prej të gjithë nxënësve-pjesëmarrës nga shkollat e mesme (fillore/të mesme) janë nga gjuha mësimore Maqedonase. Nëse i marrim numrat e përgjithshëm, nxënësit-pjesëmarrës që mësojnë në gjuhën Maqedonase përbëjnë 62%/61% nga numri i përgjithshëm i nxënësve që kanë marrë pjesë në aktivitetet e përbashkëta mësimore në shkollat fillore/të mesme. Në qoftë se supozohet se numrat e raportuar janë të saktë, paraqitet se nxënësit që mësojnë në gjuhën Maqedonase janë përfaqësuar më tepër në grupet e “përzier”, jo vetëm te ato prej shkollave një-gjuhëshe, por po ashtu edhe te ato që mësojnë në shkollat shumë-gjuhëshe.

Tabela 3.3.4.

Mësimdhënësit nga gjuhë të ndryshme mësimore që kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta mësimore me nxënës (nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të përfshirë në shkollat fillore/të mesme)

		Shkolla fillore (154)	Shkolla të mesme (25)
MAQ	një-gjuh.	561 (72,9%)	67 (74,4%)
	shumë-gjuh.	351 (49,1%)	170 (64,9%)
ShQ	një-gjuh.	207 (26,9%)	23 (25,6%)
	shumë-gjuh.	271 (37,9%)	85 (32,4%)
TUR	një-gjuh.	2 (0,3%)	0
	shumë-gjuh.	78 (10,9%)	7 (2,7%)
SER	një-gjuh.	0	0
	shumë-gjuh.	5 (0,7%)	0
BOSh	një-gjuh.	0	0
	shumë-gjuh.	10 (1,4%)	0
Gjithsej	një-gjuh.	770	90
	shumë-gjuh.	715	262

Rezultatet në Tabelën 3.3.4 tregojnë se ka pasur po ashtu edhe jobalancë gjuhësore në pjesëmarrjen e mësimdhënësve në aktivitetet e përbashkëta mësimore me nxënës në favor të gjuhës Maqedonase. Mësimdhënësit nga gjuha Maqedonase përbëjnë 73%/74% të pjesëmarrësve nga shkollat një-gjuhëshe (filllore/të mesme) dhe 49%/65% të pjesëmarrësve nga shkollat shumë-gjuhëshe (filllore/të mesme). Gjithsej 61%/67% prej të gjithë pjesëmarrësve të shkollave filllore/të mesme janë nga gjuha mësimore Maqedonase.

Tabela 3.3.5. ilustron se mesatarisht 8% të nxënësve të shkollave filllore (më shumë nga nxënësit me gjuhë mësimore Maqedonase dhe më pak nga nxënësit me gjuhë mësimore Shqipe) dhe 13% të nxënësve të shkollave të mesme (më shumë nga nxënësit me gjuhë mësimore Shqipe dhe më pak nga nxënësit me gjuhë mësimore Maqedonase) janë përfshirë në aktivitetet e përbashkëta mësimore të realizuara në shkollat e tyre. Një përqindje shumë më e lartë e pjesëmarrësve mund të shihet te nxënësit që mësojnë në gjuhët e pakicave etnike, si ajo Serbe dhe Boshnjake. Kur krahasohen përqindjet e mësimdhënësve-pjesëmarrës, paraqitet se më shumë ka prej mësimdhënësve që japin mësim në shkollat filllore se sa në ato të mesme (18,5%ndaj 11%). Këtu, raporti gjuhësor Maqedonas-Shqiptarë reflekton atë që vlen për nxënësit-pjesëmarrës.

Tabela 3.3.5.
Pjesa e mësimdhënësve/nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore që kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta mësimore me nxënës (nga numri i përgjithshëm i nxënësve/mësimdhënësve në shkollat që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta jashtë-mësimore)

		Shkolla filllore (154)	Shkolla të mesme (25)
MAQ	nxënës	4.577 (9%)	1.339 (10,8%)
	mësimdhënës	912 (19%)	237 (9,3%)
ShQ	nxënës	2.112 (6,1%)	818 (18,2%)
	mësimdhënës	478 (16,8%)	108 (24,8%)
TUR	nxënës	520 (12,5%)	46 (15,3%)
	mësimdhënës	80 (24,6%)	7 (2,2%)
SER	nxënës	18 (44,8%)	
	mësimdhënës	5 (28,1%)	
BOSH	nxënës	114 (36,7%)	
	mësimdhënës	10 (46,7%)	
Gjithsej	nxënës	7.341 (8,2%)	2.203 (12,8%)
	mësimdhënës	1.485 (18,5%)	352 (10,7%)

Rezultatet nga vizitat për verifikim tregojnë se:

- Në përgjithësi, orët e rregullta të përbashkëta të realizuara gjithmonë janë realizuar në më pak se pesë orë dhe gjithmonë me grup të zgjedhur të nxënësve (jo me tërë klasat). Kur bëhet fjalë për aktivitetet mësimore dhe projektet mësimore, është e pa qartë se vallë kanë përfshirë përmbajtje aktuale mësimore, nuk ka shënim se sa nxënës kanë qenë të përfshirë dhe se sa takime janë organizuar.
- Orët e përbashkëta jo gjithmonë janë realizuar duke u përmbajtur rregullave oficiale për realizimin e tyre (kryerjen e aktiviteteve mësimore jashtë shkollës, në kohëzgjatje prej më së paku tri ditësh). Kështu, secili aktivitet i realizuar në mjedis natyror jashtë shkollës konsiderohet si orë në natyrë.
- Nuk mund të vërtetohet se aktivitetet mësimore afatgjate në shkollat e mesme që duhet të konsiderohen si lëndë të rregullta janë realizuar në bazë të rregullt.


Përfshirja e prindërve në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve

Të dhënat nga Tabela 3.4.1 tregojnë se shumicat e shkollave (edhe fillore edhe të mesme) që kanë realizuar aktivitetet e përbashkëta të nxënësve kanë përfshirë prindër në realizimin e tyre. Pjesa e shkollave një-gjuhëshe me prindër aktiv është pak më e lartë se ato që janë të vendosura në komunat heterogjene se sa te ato në komunat homogjene. Kur bëhet krahasim mes shkollave fillore dhe atyre të mesme, del në pah që prindërit kanë qenë më aktiv te shkollat fillore se sa te ato të mesme, posaçërisht kur krahasohen shkollat një-gjuhëshe nga komunat homogjene me shkollat me më shumë se një gjuhë mësimore.

Tabela 3.4.1.
Shkollat me prindër që kanë marrë pjesë në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve (nga shkollat me aktivitetet e përbashkëta me nxënës)

	Shkolla fillore (246)	Shkollat të mesme (51)
KHo një-gjuh.	45 (84,9%)	11 (68,8%)
KHe një-gjuh.	90 (88,2%)	7 (87,5%)
Shumë-gjuh.	80 (87,9%)	20 (74,1%)

Sipas rezultateve të paraqitura në Grafikonin 3.4., shumica e shkollave fillore dhe të mesme të vendosura në komuna me dy/tre gjuhë mësimore kanë pasur prindër të përfshirë në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve. Dy format tjera të përfshirjes së prindërve (në krijimin dhe zbatimin e përbashkët dhe/ose vendim marrje të përbashkët) paraqiten më shumë te shkollat fillore se sa te ato të mesme.



Grafikoni 3.4.
Formatet e përfshirjes së prindërve në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve (nga shkollat që i kanë realizuar këto aktivitetet)

Tabela 3.4.2 tregon se 18 shkolla as nuk kanë ftuar prindërit të marrin pjesë në aktivitetet e përbashkëta me nxënës. 17 shkolla tjera deklarojnë se prindërit e tyre nuk janë të interesuar të bashkëpunojnë rreth aktiviteteve PINA, ndërsa 9 shkolla thonë se prindërit e tyre nuk janë të interesuar të bashkëpunojnë me shkollën për asnjë lloj aktiviteti.

Tabela 3.4.2. Arsyet se pse nuk janë përfshirë prindërit (nga shkollat që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta të nxënësve pa pjesëmarrje të prindërve)

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej (44)
	KHo një-gjuh. (8)	Khe një-gjuh. (12)	shumë-gjuh. (11)	KHo një-gjuh. (5)	KHe një-gjuh. (1)	shumë-gjuh. (7)	
Nuk i kanë ftuar	6	5	3	0	1	3	18 (40.9%)
Mungesë të interesit për bashkëpunim rreth aktiviteteve PINA	2	7	3	3	0	2	17 (38,6%)
Mungesë të interesit për bashkëpunim për çfarëdo lloj aktiviteti	0	0	5	2	0	2	9 (79,5%)

Rezultatet nga vizitat për verifikim tregojnë se:

- Në të shumtat e rasteve, nuk ka shënime oficiale për pjesëmarrjen e prindërve në aktivitetet e përbashkëta me nxënës.
- Kur bëhet fjalë për përfshirjen e prindërve, tregues për kyçjen e tyre në vendim marrje kryesisht është marrja e pajtueshmërisë nga prindi për realizimin e aktivitetit/eve.

Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta profesionale për mësimdhënës

Kur janë pyetur se vallë mësimdhënësit e tyre kanë qenë të përfshirë në aktivitete për zhvillim profesional me kolegë nga ndonjë shkollë me gjuhë tjetër mësimore (Tabela 4.1.), shumica e shkollave nga komunat heterogjene (më shumë shkollat shumë-gjuhëshe se sa një-gjuhëshe) kanë dhënë përgjigje pohuese. Siç është pritur, shumica e shkollave një-gjuhëshe nga komunat një-gjuhëshe (61% nga shkollat fillore dhe të mesme) janë përgjigjur negativisht. Të dhënat po ashtu tregojnë se shumica e shkollave shumë-gjuhëshe kanë pasur përvojë të tillë në kuadër të vetë shkollave të tyre.

Tabela 4.1.
Sa aktivitete të përbashkëta profesionale me mësimdhënës janë realizuar (nga të gjitha shkollat)

		Shkolla fillore (327)	Shkolla të mesme (88)
në partneritet	KHo një-gjuh	33 (39,3%)	17 (38,6%)
	KHe një-gjuh	86 (57,3%)	4 (28,6%)
	shumë-gjuh.	9 (9,7%)	1 (3,33%)
në kuadër të shkollës	shumë-gjuh.	52 (55,9%)	19 (63,3%)
në të dyja mënyrat	shumë-gjuh.	12 (12,9%)	5 (16,7%)

Rezultatet në Tabelën 4.2 tregojnë se 50% të aktiviteteve të përbashkëta për zhvillim profesional të mësimdhënësve të shkollave fillore dhe 70% të aktiviteteve të njëjta të synuar për mësimdhënësit e shkollave të mesme janë realizuar në shkollat shumë-gjuhëshe. Në përgjithësi, llojet më të përhapura të këtyre aktiviteteve mes shkollave fillore dhe të mesme janë: zhvillimi i përbashkët i planeve mësimore, shkëmbimi i materialeve mësimore dhe pjesëmarrja në trajnime të përbashkëta ose trupe profesionale.

Tabela 4.2. Llojet e ndryshme të aktiviteteve të përbashkëta profesionale (nga shkollat që kanë raportuar që i kanë këto aktivitete)

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej (238)
	KHo një-gjuh. (33)	KHe një-gjuh. (86)	shumë- gjuh. (73)	KHo një-gjuh. (17)	KHe një-gjuh. (4)	shumë- gjuh. (25)	
Zhvillimi i planeve mësimore	16 (48,5%)	50 (58,1%)	56 (76,7%)	8 (47,1%)	3 (75%)	22 (88%)	155 (65,1%)
Hartimi i testeve dhe instrumenteve tjera për matjen e suksesit	7 (21,2%)	23 (26,7%)	40 (54,8%)	3 (17,6%)	1 (25%)	17 (68%)	91 (38,2%)
Pjesëmarrja në trajnime të përbashkëta/trupe të përbashkëta profesionale	19 (57,6%)	43 (50%)	54 (74%)	5 (29,4%)	1 (25%)	19 (76%)	141 (59,2%)
Vizita dhe vëzhgimi i orëve	6 (18,2%)	28 (32,6%)	42 (57,5%)	6 (35,3%)		9 (36%)	91 (38,2%)
Shkëmbimi i materialeve mësimore	18 (54,5%)	50 (58,1%)	56 (76,7%)	12 (70,6%)		20 (80%)	156 (65,5%)
Zgjidhja e problemeve në shoqëri	5 (15,2%)	11 (12,8%)	32 (43,8%)	3 (17,6%)	1 (25%)	15 (60%)	67 (28,2%)
Gjithsej	71	205	280	37	6	102	701

Prej 3523 mësimdhënësve nga 192 shkolla fillore dhe 1478 mësimdhënësve nga 46 shkolla të mesme që kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta për zhvillim profesional, më shumë se 60% janë femra (68% të mësimdhënësve nga shkollat fillore- dhe 60% të mësimdhënësve nga shkollat e mesme). Sipas të dhënave në Tabelën 4.3, më shumë se gjysma e mësimdhënësve të kyçur në aktivitetet e përbashkëta profesionale janë nga gjuha mësimore Maqedonase. Siç ishte e pritur, mes mësimdhënësve nga gjuhët tjera mësimore, ata që japin mësim në gjuhën Shqipe janë më të përfaqësuar, ndërsa ata që japin mësim në gjuhën Serbe dhe Boshnjake janë të pakta në numër.

Tabela 4.3. Mësimdhënësit nga gjuhë të ndryshme mësimore që kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta profesionale (nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të përfshirë në shkollat fillore/të mesme)

		Shkolla fillore (192)	Shkolla të mesme (46)
MAQ	një-gjuh.	911 (69,4%)	153 (60,2%)
	shumë-gjuh.	1.117 (50,5%)	743 (60,7%)
ShQ	një-gjuh.	396 (30,2%)	101 (39,8%)
	shumë-gjuh.	928 (42%)	440 (35,9%)
TUR	një-gjuh.	6 (0,5%)	
	shumë-gjuh.	142 (6,4%)	41 (3,3%)
SER	një-gjuh.		
	shumë-gjuh.	15 (0,7%)	
BOSH	një-gjuh.		
	shumë-gjuh.	8 (0,4%)	
Gjithsej	një-gjuh.	1313	254
	shumë-gjuh.	2.210	1.224

Sipas Tabelës 4.4, përqindja mesatare e mësimdhënësve të përfshirë në ndonjë lloj të aktiviteteve të përbashkëta profesionale është mjaft e lartë (37% të mësimdhënësve nga shkollat fillore- dhe 30% të atyre nga shkollat e mesme). Krahasimet ndër-gjuhësore tregojnë se përqindja e mësimdhënësve të përfshirë që japin mësim në gjuhën Shqipe është më e lartë se përqindja e mësimdhënësve që japin

mësim në gjuhën Maqedonase, dhe ky dallim është shumë më i madh mes mësimdhënësve nga shkollat e mesme.

Tabela 4.4.
Pjesa e mësimdhënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore që kanë marrë pjesë në aktivitete të përbashkëta profesionale (nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të shkollave që kanë realizuar kësi lloj aktiviteteve)

	Shkolla fillore (192)	Shkolla të mesme (46)
MAQ	2.028 (34,8%)	896 (27,4%)
ShQ	1.324 (38,7%)	541 (40,6%)
TUR	148 (51,1%)	41 (12%)
SER	15 (54%)	
BOSh	8 (37,4%)	
Gjithsej	3.523 (36,8%)	1.478 (29,9%)

Rezultatet nga vizitat për verifikim tregojnë se:

- Zakonisht, bashkëpunimi profesional mes mësimdhënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore nënkupton planifikim të aktiviteteve të përbashkëta me nxënës, dhe takimet e realizuar për atë qëllim janë llogaritur si bashkëpunim profesional.

Realizimi i aktiviteteve tjera PINA

Ikonografia multikulturore


Tabela 5.1.1. paraqet se shumica e shkollave (posaçërisht shkollat fillore shumë-gjuhëshe) deklarojnë se ikonografia e tyre shkollore jo vetëm që përmban material që ka të bëjë me identitetin e bashkësive të ndryshme etnike që jetojnë në vend, por po ashtu edhe i prezantojnë në mënyrë të balancuar. Te shkollat e mesme një-gjuhëshe, ka një pjesë të madhe të atyre që nuk kanë ikonografi multikulturore thjesht sepse të gjithë nxënësit e tyre mësojnë në një gjuhë.

Tabela 5.1.1. Prezenca e materialit vizual që ka të bëjë me identitetin e bashkësive të ndryshme etnike që jetojnë në RM (përqindja e të gjitha shkollave)

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej (415)
	KHo një-gjuh. (84)	KHe një-gjuh. (150)	shumë- gjuh. (93)	KHo një-gjuh. (44)	KHe një-gjuh. (14)	shumë- gjuh. (30)	
PO-prezencë të balancuar	44 (52,4%)	73 (48,7%)	64 (68,8%)	21 (47,7%)	7 (50%)	14 (46,7%)	223 (53,7%)
PO-jobalancë të lehtë	18 (21,4%)	37 (24,7%)	24 (25,8%)	4 (9,1%)		7 (23,3%)	90 (21,7%)
PO- jobalancë të theksuar	4 (4,8%)	4 (2,7%)				2 (6,7%)	10 (2,4%)
JO-nuk ka nevojë		5 (3,3%)	3 (3,2%)	3 (6,8%)		6 (20%)	17 (4,1%)
JO-shkollë një-gjuhëshe	18 (21,4%)	31 (20,7%)	2 (2,2%)	16 (36,4%)	7 (50%)	1 (3,3%)	75 (18,1%)

Siç zbulon Grafikoni 5.1, një shumicë e konsiderueshme e shkollave fillore dhe të mesme që kanë ikonografi multikulturore në muret e tyre, e sigurojnë këtë përmes paraqitjes së fotografive, vizatimeve, objekteve dhe/ose materialeve të shkruar që reflektojnë traditën/literaturën/artin e bashkësive të ndryshme. Përveç kësaj, shumica e shkollave shumë-gjuhëshe paraqesin material

dhe/ose produkte tjera të krijuar nga nxënësit me përkatësi të ndryshme etnike. Nga ana tjetër, përmbajtjet historike dhe/ose personazhet historik përfaqësues të bashkësive të ndryshme etnike janë të dukshme në një pjesë të madhe të shkollave një-gjuhëshe.



Grafikoni 5.1. Përmbajtja e materialit vizual që ka të bëjë me bashkësi të ndryshme mësimore (nga shkollat me ikonografi multikulturore të balancuar ose me jobalancë të lehtë)

Aktivitetet PINA në shkollat me pakica etnike

Të dhënat në Tabelën 5.2.1 tregojnë se ekzistojnë 33 shkolla fillore dhe 13 të mesme në vend me numër të konsiderueshëm të pakicave etnike (mbi 10% prej numrit të përgjithshëm të nxënësve) që nuk mësojnë në gjuhën e tyre amtare. Shumë prej tyre kanë nxënës nga pakica Rome dhe Turke, por po ashtu ka edhe shkolla me prezencë të pakicave tjera etnike.⁸

Tabela 5.2.1. Shkollat me prezencë të rëndësishme të pakicave etnike që nuk mësojnë në gjuhën e tyre amtare

	Shkolla fillore	Shkolla të mesme
ROM	15	5
ROM & TUR	3	1
TUR	8	2
TUR & BOSH	1	1
ShQ		1
BOSH	4	
EGj	1	
SER	1	
VLIE		1
të tjerë		2
	33	13

⁸ Nga gjithësej 33 shkolla fillore me pjesë të madhe të pakicave etnike, vetëm 9 sigurojnë lëndë zgjedhore në gjuhën dhe kulturën Rome/Turke/Vllahe/Boshnjake. Njëkohësisht, 28 nga shkollat fillore dhe 10 nga shkollat e mesme me pakica etnike kanë realizuar aktivitete të përbashkëta.

Sipas të dhënave të prezantuara në Tabelën 5.2.2 paraqitet se nxënësit e pakicave janë përfshirë në shumicën e aktiviteteve të përbashkëta që janë realizuar në shkollën e tyre. Sidoqoftë, është interesant fakti se thuajse të gjithë shkollat (edhe fillore edhe të mesme) me nxënës prej pakicave i kanë përfshirë ata në shfaqjet shkollore.

Tabela 5.2.2.


Llojet e aktiviteteve të përbashkëta që përfshijnë nxënës nga pakicat (nga shkollat me prezencë të konsiderueshme të pakicës/ave etnike që i kanë përfshirë ato në aktivitetet e përbashkëta të nxënësve)

	Shkolla fillore (28)	Shkolla të mesme (10)
Shëtitje	21 (75%)	5 (50%)
Shfaqje	25 (89,3%)	9 (90%)
Kremtime/aktivitete sociale	11 (39,3%)	5 (50%)
Aksione ekologjike	22 (78,6%)	6 (60%)
Evenimente në bashkësinë lokale	12 (42,9%)	7 (70%)
Punëtori multikulturore	25 (89,3%)	6 (60%)
Aktivitete të lira të nxënësve	20 (71,4%)	8 (80%)
Aktivitete sportive	22 (78,6%)	7 (70%)
Aksione humanitare	16 (57,1%)	4 (40%)
Seksione	19 (67,9%)	7 (70%)
Ekipe sportive	16 (57,1%)	3 (30%)
Aktivitete nga mësimi i rregullt	13 (46,4%)	4 (40%)
Projekte në kuadër të orëve të rregullta mësimore	11 (39,3%)	5 (50%)
Mësimi në natyrë (në ShF)	13 (46,4%)	
Ekipe sportive	21 (75%)	5 (50%)
Gjithsej	264	77


Bashkëpunimi me komunën

Sipas Grafikonit 5.3.1, pas fillimit të Projektit për Integrim Ndëretnik Në Arsim, më së paku gjysma e shkollave fillore nga komunat heterogjene dhe shumica e shkollave të mesme një-gjuhëshe të vendosura në komunat heterogjene e kanë përforcuar bashkëpunimin e tyre me komunën në lidhje me aktivitetet PINA. Kategoritë tjera të shkollave fillore dhe të mesme vetëm e kanë vazhduar bashkëpunimin që ka qenë i filluar para PINA-s. Pjesa e shkollave pa bashkëpunim me komunat në lidhje me aktivitetet INA është tepër e vogël.

Grafikoni 5.3.2. tregon se forma më e shpeshtë e bashkëpunimit me komunën është informimi i saj rreth aktiviteteve INA që janë realizuar në shkollë. Po ashtu është e dukshme që shumica e shkollave e kanë përfshirë komunën në monitorimin e aktiviteteve të tyre INA. Një pjesë e madhe e shkollave marrin kurajo nga komunat e tyre që të realizojnë aktivitete INA por ajo nuk është gjithmonë e ndjekur me mbështetje financiare.



Grafikoni 5.3.1.
Bashkëpunimi aktiv i shkollave me komunën në lidhje me aktivitetet INA (nga të gjitha shkollat)



Grafikoni 5.3.2.
Format e bashkëpunimit me komunat rreth aktiviteteve INA (nga shkollat që kanë bashkëpunim)

Ndikimi i aktiviteteve PINA

Tabela 6.1. Dobishmëria e aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve për raportet mes nxënësve nga përkatësitë e ndryshme etnike/grupet e ndryshme gjuhësore (nga shkollat që i kanë realizuar këto lloj aktivitete)

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej (297)
	KHo një-gjuh. (53)	KHe një-gjuh. (102)	shumë-gjuh. (91)	KHo një-gjuh. (16)	KHe një-gjuh. (8)	shumë-gjuh. (27)	
Zvogëlimi i stereotipave/para gjykimeve etnike	42 (79,2%)	63 (61,8%)	55 (60,4%)	11 (68,8%)	5 (62,5%)	18 (66,7%)	194 (65,3%)
Përmirësimi i kontaktit ndër-etnik/gjuhësor	9 (17,0%)	32 (31,4%)	26 (28,6%)	4 (25%)	2 (25%)	9 (33,3%)	82 (27,6%)
Zvogëlimi i konflikteve ndër-etnike/gjuhësore	2 (3,8%)	7 (6,9%)	9 (9,9%)	1 (6,3%)	1 (12,5%)	0	20 (6,7%)
Nuk janë të dobishme për raportet ndër-etnike/gjuhësore	0	0	1 (1,1%)	0	0	0	1 (0,3%)

Tabela 6.2. Dobishmëria dhe realizueshmëria e llojeve të ndryshme të aktiviteteve të përbashkëta të nxënësve për raportet mes nxënësve nga përkatësitë e ndryshme etnike/grupet e ndryshme gjuhësore (nga shkollat që kanë realizuar këto lloj aktivitete)

	Shkolla fillore			Shkolla të mesme			Gjithsej (297)
	KHo një.gjuh. (53)	KHe një-gjuh. (102)	shumë-gjuh. (91)	KHo një.gjuh. (16)	KHe një-gjuh. (8)	shumë-gjuh. (27)	
Shëtitje të përbashkëta	4 (7,5%)	13 (12,7%)	13 (14,3%)	1 (6,3%)	3(11,1%)	3 (37,5%)	37 (12,5%)
Vizita të ndërsjella	15 (28,3)	14 (13,7%)	17 (18,7%)	8 (50%)	2 (7,4%)		56 (18,9%)
Manifestime/kretime të përbashkëta	2 (3,8%)	9 (8,8%)	10 (11%)	2(12,5%)	2 (7,4%)		25 (8,4%)
Aksione ekologjike		3 (2,9%)	2 (2,2%)				5 (1,7%)
Aktivitete të përbashkëta multikulturore	17 (32,1%)	27 (26,5%)	21 (23,1%)	3 (18,8%)	8 (29,6%)		76 (25,6%)
Aktivitete të përbashkëta të lira të nxënësve	6 (11,3%)	5 (4,9%)	9 (9,9%)	1 (6,3%)	4 (14,8%)	2 (25%)	27 (9,1%)
Aktivitete të përbashkëta sportive	2 (3,8%)	12 (11,8%)	7 (7,7%)	1(6,3%)	3 (11,1%)		25 (8,4%)
Aksione dhe projekte të përbashkëta	3(5,7%)	8 (7,8%)	8 (8,8%)			2 (25%)	21 (7,1%)
Seksione të përbashkëta		2 (2%)	2 (2,2%)			1(12,5%)	5 (1,7%)
Aktivitete të përbashkëta në mësim të rregullt	1 (1,9%)	1 (1%)	1 (1,1%)		2 (7,4%)		5 (1,7%)
Aktivitete të përbashkëta projektuese	3 (5,7%)	6 (5,9%)	1 (1,1%)		2 (7,4%)		12 (4%)
Orë të lira të përbashkëta (në shkollat profesionale)							0
Mësim praktik (në shkollat profesionale)					1 (3,7%)		1 (0,3%)

Prej 297 shkollave që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta me grupe “të përzier” të nxënësve vetëm një shkollë fillore shumë-gjuhëshe është përgjigjur se këto aktivitete nuk janë të dobishme për raportet mes nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore. Ashtu siç paraqet Tabela 6.1, shumica e shkollave (edhe fillore edhe të mesme nga të tre kategoritë) kanë deklaruar se aktivitetet e përbashkëta janë të dobishme më së shumti për reduktimin e stereotipeve dhe paragjykimëve negative, një pjesë më e vogël që këto aktivitete ndihmojnë më së shumti në përmirësimin e kontaktit, dhe pjesa më e vogël se ato janë të dobishëm më së shumti për reduktimin e konflikteve mes nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore.

Të dhënat nga Tabela 6.2 tregojnë se kur bashkohen përgjigjet prej të gjitha shkollave del se prej aktiviteteve të përbashkëta më të famshmet janë aktivitetet e përbashkëta multikulturale, vizitat e ndërsjella dhe shëtitjet e përbashkëta. Njëkohësisht, aktivitetet mësimore si dhe aktivitetet afatgjate që duhet të jenë më të dobishmet për raportet ndëretnike/ndërgjuhësore mes nxënësve, janë perceptuar si të tilla nga numri më i vogël i shkollave. Mes shkollave shumë-gjuhëshe që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta, aktivitetet multikulturale janë më të famshmet në nivel të shkollave fillore, ndërsa shëtitjet e përbashkëta janë më të famshme në nivelin e shkollave të mesme.

Tabela 6.3.
Kontributi i aktiviteteve INA në shkallë prej 1=*aspak* deri 5=*shumë* (prej të gjitha shkollave)

		Shkolla fillore (327)	Shkolla të mesme (88)
Përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike/ ndërgjuhësore mes mësimdhënësve	KHo një-gjuh.	3,7	3,2
	KHe një-gjuh	3,8	3,6
	shumë-gjuh.	3,8	4,1
Përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike/ ndërgjuhësore mes nxënësve	KHo një-gjuh.	4,0	3,4
	KHe një-gjuh	3,9	4,1
	shumë-gjuh.	4,0	4,0
Përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike/ ndërgjuhësore mes prindërve	KHo një-gjuh.	3,4	3,0
	KHe një-gjuh	3,4	3,3
	shumë-gjuh.	3,5	3,2
Përmirësimi i atmosferës së përgjithshme në shkollë	KHo një-gjuh.	3,7	3,5
	KHe një-gjuh	3,7	3,6
	shumë-gjuh.	3,9	3,6
Përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike/ ndërgjuhësore në komunë	KHo një-gjuh.	3,3	3,3
	KHe një-gjuh	3,8	3,6
	shumë-gjuh.	4,1	3,5

Gjatë evaluimit të kontributit të aktiviteteve për integrim ndëretnik në aspekte të ndryshme të jetës shkollore (Tabela 6.3), shkollat ne përgjithësi i shohin sit ë dobishme. Të gjithë, përveç njëres nga vlerat e fituara mesatare janë mbi mesit të shkallës së vlerësimit (3,0), që tregon përmirësim më shumë se mesatarja në të gjitha aspektet e evaluara gjatë realizimit të aktiviteteve INA. Mesatarisht, shkollat fillore tregojnë tendencë për ti vlerësuar aktivitetet më lartë se sa shkollat e mesme. Po ashtu ka tendencë për shkollat nga komunat heterogjene (edhe një-gjuhëshe edhe shumë-gjuhëshe) që ti shohin aktivitetet si më të vlefshme nga shkollat një-gjuhëshe nga komunat homogjene. Sidoqoftë, vlerat e fituara mesatare për efektin në marrëdhëniet ndëretnike/ndërgjuhësore mes nxënësve janë më të lartat dhe ato për efektin në marrëdhëniet ndëretnike/ndërgjuhësore mes prindërve të tyre janë më të ulëtat.

Tabela 6.4 tregon se shumica e shkollave (të gjitha kategoritë dhe edhe shkollat fillore edhe ato të mesme) nuk besojnë se ndërprerja e aktiviteteve për integrim ndëretnik në shkollat do të ndikojnë në marrëdhëniet ndëretnike/ndër-gjuhësore mes nxënësve, mes mësimeve, ose mes prindërve. Në kontekst të hulumtimeve rreth efektit të këtyre aktiviteteve në marrëdhëniet mes pjesëmarrësve të ndryshëm në procesin arsimor, këto rezultate sigurisht nënkuptojnë që aktivitetet INA i kanë përmirësuar marrëdhëniet në shkollë që do të kishte qenë vështirë të ndryshojnë. Në përgjithësi, marrëdhëniet e arritura mes mësimeve nga gjuhë të ndryshme mësimore konsiderohen si të qëndrueshme nga shumica e shkollave.

Tabela 6.4. Çfarë pritet të ndodhë me marrëdhëniet mes nxënësve/mësimeve/prindërve nga gjuhë të ndryshme mësimore në qoftë se ndërpriten aktivitetet INA (nga të gjitha shkollat)

		Shkollat fillore (327)			Shkollat e mesme (88)		
		më mirë	njëjtë	më keq	më mirë	njëjtë	më keq
nxënësit	KHo një-gjuh.	6 (7,1%)	68 (81%)	10 (11,9%)	2 (4,5%)	38 (86,4%)	4 (9,1%)
	KHe një-gjuh.	13 (8,7%)	122 (81,3%)	15 (10%)	1 (7,1%)	12 (85,7%)	1 (7,1%)
	shumë-gjuh.	10 (10,8%)	68 (73,1%)	15 (16,1%)	2 (6,7%)	24 (80%)	4 (13,3%)
mësimi	KHo një-gjuh.	6 (7,1%)	64 (76,2%)	16 (16,7%)	2 (4,5%)	37 (84,1%)	5 (11,4%)
	KHe një-gjuh.	12 (8%)	114 (76%)	24 (16%)	1 (7,1%)	11 (78,6%)	2 (14,3%)
	shumë-gjuh.	7 (7,5%)	61 (65,6%)	25 (26,9%)	4 (13,3%)	21 (70%)	5 (16,7%)
prindërit	KHo një-gjuh.	6 (7,1%)	65 (77,4%)	13 (15,5%)	2 (4,5%)	37 (84,1%)	5 (11,4%)
	KHe një-gjuh.	9 (6%)	122 (81,3%)	19 (12,7%)	1 (7,1%)	11 (78,6%)	2 (14,3%)
	shumë-gjuh.	9 (9,7%)	64 (68,8%)	20 (21,5%)	2 (6,7%)	25 (83,3%)	3 (10%)

PËRFUNDIME

1. Sigurimi i kushteve për realizimin e aktiviteteve INA

- Thuajse të gjitha shkollat kanë SIT funksional që parimisht kanë qenë të angazhuar në krijimin e etapës për futjen e aktiviteteve të përbashkëta me grupe “të përzier” të nxënësve dhe sigurimin e realizimit të këtyre aktiviteteve.
- 4/5 vitet e fundit, shumica e mësimit ndërhënësve nga thuajse të gjitha shkollat kanë kaluar një lloj trajnimi për integrim ndëretnik në arsim.
- Shumica e shkollave nga të gjitha kategoritë e kanë zbuluar përkushtimin e tyre ndaj aktiviteteve INA në misionet/vizionet e tyre dhe kanë inkuadruar aktivitete INA në planet e tyre vjetore.
- Këshilli shkollor nga thuajse të gjitha shkollat është i informuar rreth aktiviteteve INA dhe në disa raste përfaqësuesit e tyre kanë marrë pjesë në trajnimet INA dhe/ose aktivitetet INA.
- Një përqindje e madhe e shkollave (më shumë prej shkollave fillore se sa prej atyre të mesme) kanë arritur të sigurojnë bashkëpunim me këshillin prindëror përmes aktiviteteve INA.
- Shumica e shkollave kanë vendosur partneritet me shkollë tjetër/shkolla tjera me gjuhë të ndryshme mësimore. Më të përfaqësuara mes tyre janë shkollat një-gjuhëshe të vendosura në komunat heterogjene, dhe shkollat shumë-gjuhëshe kanë ofruar tu shërbejnë shkollave një-gjuhëshe si mundësi të përshtatshme për partneritet/e. Gjysma e shkollave kanë vendosur marrëdhënie partnerike me vetëm një shkollë, por një pjesë e vogël e tyre (kryesisht shkollat shumë-gjuhëshe) kanë 3-5 partneritete.

2. Realizimi i përgjithshëm i aktiviteteve INA në shkollat

- Shumica e shkollave që kanë vendosur partneritet/e kanë arritur ta bëjnë partneritetin e tyre të jetë funksional. Sidoqoftë, akoma ka shumë partneritete të krijuara, posaçërisht mes shkollave të mesme por që nuk janë aktiv. Edhe pse në vitin 2015/16 janë vendosur më shumë partneritete në krahasim me vitin shkollor paraprak, tani ka më pak partneritete funksionale. Shumica e shkollave shumë-gjuhëshe pa partneritet efektiv nuk e shohin partneritetin të domosdoshëm për realizimin e aktiviteteve INA, dhe shkollat një-gjuhëshe kanë arsytime të ndryshme, nga fajësimi i shkollës partnere e deri në largësinë hapësinore e mungesën e kohës.
- Për thuajse të gjitha shkollat nga të tre kategoritë (edhe fillore edhe të mesme), partneritetet janë bërë efektive përmes vizitave të shkollës/ave partnere. Takimet e rregullta me shkollat partnere kanë qenë më të shpeshta mes shkollave fillore një-gjuhëshe nga komunat heterogjene dhe më së pakti prezent mes shkollave të mesme shumë-gjuhëshe.

3. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta me nxënës

- Aktivitetet e përbashkëta të nxënësve janë realizuar më shumë në shkollat fillore se sa ato të mesme. Te shkollat fillore, ato janë realizuar kryesisht në shkollat e vendosura në komunat heterogjene (edhe një-gjuhëshe edhe shumë-gjuhëshe), ndërsa te shkollat e mesme ato më së shumti ishin prezent në shkollat shumë-gjuhëshe.

- Mungesa e vullnetit të shkollës/ave partnere për bashkëpunim dhe mungesa e mbështetjes financiare konsiderohen si arsye kryesore për mungesën e aktiviteteve të përbashkëta me nxënës nga shumica e shkollave.
- Shumica e aktiviteteve të përbashkëta të realizuara me nxënës janë aktivitete jashtë-mësimore afat-shkurte siç janë: shëtitjet e përbashkëta, shfaqjet, aktivitetet multikulturore dhe ngjarjet sportive. Shkollat një-gjuhëshe kanë realizuar ato gjatë vizitave të shkollës/ave partnere, ndërsa shumica e shkollave shumë-gjuhëshe kanë aritur ti përfshijnë vetëm nxënësit e tyre që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore.
- Aktivitetet e përbashkëta mësimore kanë qenë të rralla derisa edhe të shkollat shumë-gjuhëshe. Kur kanë ekzistuar, ato kanë qenë më shumë në formë të aktiviteteve afat-shkurte që nuk kanë përfshirë klasa të tëra dhe sigurisht janë realizuar jashtë orëve të rregullta mësimore.
- Mesatarisht, grupet e “përziera” të nxënësve kanë qenë të jobalancuar në favor të atyre që mësojnë në gjuhën Maqedonase dhe mësimdhënësit nga gjuha mësimore Maqedonase dhe mësimdhënësit në përgjithësi janë të tejpreferuar mes mësimdhënësve që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta me nxënës.
- Në përgjithësi, rreth 10% të nxënësve (edhe prej shkollave fillore edhe prej atyre të mesme) që mësojnë në gjuhën Maqedonase ose Shqipe kanë qenë të përfshirë në aktivitetet e përbashkëta jashtë-mësimore. Përqindjet e mësimdhënësve-pjesëmarrës që japin mësim në këta dy gjuhë mësimore janë më të larta.
- Shumica e shkollave që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta të nxënësve kanë përfshirë prindër në realizimin e aktiviteteve. Shkollat pa përfshirje të prindërve janë ato që ose nuk i kanë ftuar prindërit ose kanë prindër të pa interesuar për pjesëmarrje në kësi lloj aktiviteteve.

4. Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta profesionale për mësimdhënës

- Vetëm rreth gjysma e shkollave (edhe fillore edhe të mesme) kanë raportuar përfshirje të mësimdhënësve të tyre në aktivitetet e përbashkëta profesionale. Rreth një e treta e mësimdhënësve nga këta shkolla kanë qenë të përfshirë në ndonjë lloj të aktiviteteve të përbashkëta profesionale, dhe mes tyre, pjesa e mësimdhënësve që japin mësim në gjuhën Shqipe është më e lartë se sa pjesa e atyre që japin mësim në gjuhën Maqedonase.
- Shumica e aktiviteteve të përbashkëta për zhvillimin profesional të mësimdhënësve kanë marrë pjesë në shkollat shumë-gjuhëshe.
- Në mënyrë tipike, bashkëpunimi profesional mes mësimdhënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore, posaçërisht mes atyre që janë nga shkollat një-gjuhëshe, është reduktuar në planifikim për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me nxënës.

5. Realizimi i aktiviteteve tjera PINA

- Shumica e shkollave kanë deklaruar se ikonografia e shkollave të tyre përmban material që ka të bëjë me identitetin e bashkësive të ndryshme etnike që jetojnë në shtet. Shumica e tyre kanë raportuar se kjo ikonografi është e paraqitur në mënyrë të balancuar.
- Shkollat me përqindje të rëndësishme të nxënësve nga pakicat etnike që nuk mësojnë në gjuhën e tyre amtare (kryesisht me nxënës nga pakica Rome dhe/ose Turke) kanë përfshirë këto nxënës në shumicën e aktiviteteve të përbashkëta që janë realizuar në shkollën e tyre (thuajse të gjitha shkollat i kanë përfshirë ato në shfaqjet shkollore).

- Thuhet se të gjitha shkollat kanë bashkëpunim me komunitet e tyre lidhur me aktivitetet INA. Ata janë të informuar rreth këtyre aktiviteteve që janë realizuar në shkollë dhe në shumë raste janë të përfshirë në monitorimin e këtyre aktiviteteve. Një pjesë e madhe e shkollave marrin kurajo nga komunitet e tyre për të realizuar aktivitete INA, por kjo jo gjithmonë është e ndjekur me mbështetje financiare.

6. Ndikimi i aktiviteteve PINA

- Të gjitha shkollat (përveç një) që kanë realizuar aktivitete të përbashkëta me grupe "të përzier" të nxënësve kanë përgjigjur se këto aktivitete janë të dobishme për raportet mes nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore. Shumica e shkollave kanë deklaruar se aktivitetet e përbashkëta më së shumti janë të dobishme për reduktimin e stereotipeve dhe paragjyqimeve negative etnike; një pjesë më e vogël që këto aktivitete ndihmojnë më së shumti në përmirësimin e kontaktit, dhe pjesa më e vogël që ato janë më së shumti të dobishëm për reduktimin e konfliktit mes nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore.
- Aktivitetet më të famshme të përbashkëta paraqiten se janë aktivitetet e përbashkëta multikulturore, vizitat e ndërsjella, dhe shëtitjet e përbashkëta, kurse aktivitetet afatgjate që supozohen si më të dobishme për raportet ndër-etnike/ndër-gjuhësore mes nxënësve, perceptohen si të tilla nga numri më i vogël i shkollave.
- Në përgjithësi, shkollat besojnë se këto aktivitete kanë përmirësuar aspekte të ndryshme të jetës shkollore. Mesatarisht, shkollat fillore tregojnë tendencë për ti vlerësuar aktivitetet më lartë se sa shkollat e mesme. Po ashtu ka tendencë për shkollat nga komunitet heterogjene (edhe një-gjuhëshe edhe shumë-gjuhëshe) ti shohin aktivitetet si më të vlefshme se sa shkollat një-gjuhëshe nga komunitet homogjene.
- Shkollat perceptojnë se aktivitetet INA kanë pasur ndikim më të madh në raportet ndër-etnike/ndër-gjuhësore mes nxënësve, më pak mes mësimdhënësve, dhe më së paku në raportet mes prindërve.
- Shumica e shkollave nuk besojnë se ndërprerja e aktiviteteve INA në shkollë do të ndikojë në raportet mes nxënësve/mësimdhënësve/prindërve nga gjuhë të ndryshme mësimore me siguri për shkak se ata janë të bindur se raportet veqme janë përmirësuar deri në një shkallë që vështirë do të kishin ndryshuar.

AKTIVITETET E PËRBASHKËTA PARA DHE PAS PINA-S

Zbulimet dhe rekomandimet

Zbulimet në vijim krahasojnë rezultatet nga hulumtimi elektronik të realizuar në vitin 2016 me rezultatet nga hulumtimi i pikënisjes. Rekomandimet e dhëna pas krahasimeve sugjerojnë ndryshime në sistemin arsimor të cilët do të sigurojnë qëndrueshmëri të aktiviteteve të përbashkëta që tanimë është vërtetuar që janë efektive.

1. Para se të fillojë projekti, shkollat një-gjuhëshe nuk kanë qenë të kyçura në aktivitetet e përbashkëta me nxënës nga gjuhë të ndryshme mësimore. Në përgjithësi, nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit nuk i konsiderojnë këto aktivitete si të dobishme dhe të dëshirueshme.

PINA ka arritur të përfshijë shumicën e shkollave një-gjuhëshe (posaçërisht shkollat fillore) në formimin e partneritetit me ndonjë shkollë me gjuhë të ndryshme mësimore dhe të realizojnë aktivitete të përbashkëta kryesisht gjatë vizitave që i kanë bërë nxënësit e tyre në aktivitete të ndryshme afat-shkurte me nxënës që mësojnë në gjuhë tjetër mësimore. PINA ka trajnuar mësimdhënësit më së shumti nga shkollat një-gjuhëshe që ata ti realizojnë këto aktivitete dhe të sigurojnë kushte për nxënësit e tyre (me përkrahjen e prindërve) që të marrin pjesë në aktivitetet e përbashkëta që shpesh janë realizuar në shkollë tjetër, dhe derisa edhe në komunë tjetër.

Është shumë e rekomanduar që këto partneritete të mbështeten nga sistemi:

- Kyçja e shkollave një-gjuhëshe në aktivitetet e përbashkëta me nxënës duhet të jenë zyrtarisht të njohura dhe të vlerësuara nga autoritetet lokale dhe qendrore, dhe të përfshira në evaluimin integral të shkollave.
 - Shkollat një-gjuhëshe duhet të inkurajohen dhe të mbështeten nga autoritetet lokale dhe qendrore që përkushtimi i tyre ndaj realizimit të aktiviteteve të përbashkëta me nxënës të promovohet publikisht.
 - Përfshirja individuale e mësimdhënësve në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve zyrtarisht duhet të konsiderohet si pjesë e zhvillimit profesional të saj/tij.
 - Vizitat e shkollave tjera të shoqëruara nga aktivitete të përbashkëta me nxënës mund të kenë mbështetje eksterne financiare të siguruar nga MASH dhe/ose komunat ose mund të përfshihen në shëtitjet që organizohen rregullisht nga shkollat, pa financim ekstern.
 - Vetëm aktivitetet (mësimore ose jashtë-mësimore) që i ekspozojnë nxënësve përmbajtje eksplicite rreth kulturës dhe traditës (duke përfshirë gjuhë) të bashkësive tjera etnike që jetojnë në RM mund të konsiderohen si aktivitete multikulturore derisa edhe kur realizohen në rrethana një-gjuhësore (përveç aktiviteteve të përbashkëta që janë multikulturore vetëm duke përfshirë nxënës nga përkatësi të ndryshme etnike).
2. Para PINA-s, disa shkolla dy/tre-gjuhëshe rastësisht kanë marrë pjesë në projekte që kanë inicuar dhe kanë realizuar aktivitete të përbashkëta me nxënës nga gjuhë të ndryshme mësimore. Më të shpeshtat dhe një kohësisht aktivitetet më të dëshirueshme kanë qenë ato lloje të aktiviteteve që kanë janë mbajtur në kushte ku është mundur të kontrollohen lehtë (p.sh. grupe të vogla të nxënësve të zgjedhur sipas shtrirjes së ngushtë të interesave/aftësive) dhe/ose janë paraqitur si të përbashkëta kur në të vërtetë janë zhvilluar në mënyrë paralele (p.sh. shfaqjet multikulturore me pika të ndara muzikore, secila gjuhë mësimore në gjuhën e vetë). Aktivitetet e rregullta jashtë shkollore që kërkojnë

kontakt të drejtpërdrejtë (siç janë ekskursionet dhe shëtitjet) rrallë janë organizuar me grupe të përziera etnikisht/për nga gjuha të nxënësve.

Me kycjen e tyre në PINA, shumica e shkollave shumë-gjuhëshe kanë filluar të realizojnë aktivitete të përbashkëta me grupe “të përzier” të nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme, dhe/ose disa prej tyre kanë shërbyer si partnerë për shkollat një-gjuhëshe në realizimin e këtyre aktiviteteve. Aktivitetet e përbashkëta afat shkurte (kryesisht jashtë-mësimore dhe ndonjëherë mësimore) mbeten forma më të famshme të aktiviteteve të përbashkëta, por tani përfshirja e nxënësve dhe mësimdhënësve është më e lartë, edhe pse akoma jo mjaftueshëm. Për dallim nga më parë, shkollat tani konsiderohen si të përgjegjshme për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta – ata i iniciojnë, planifikojnë dhe i realizojnë ato, edhe pse jo gjithmonë duke i ndjekur kërkesat që sigurojnë efekte maksimale (p.sh. grupe të balancuara “të përziera” gjuhësore/etnike, trajtimi i barabartë i gjuhëve, takimet e shpeshta, dhe bashkëpunimi ndëretnik që çon deri në produkt të përbashkët).

Është shumë e rekomanduar që shkollat shumë-gjuhëshe të jenë të mbështetura në mënyrë plotësuese nga sistemi për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me nxënës:

- Angazhimi i shkollave shumë-gjuhëshe në aktivitetet e përbashkëta me nxënës (në partneritet ose në mënyrë të pavarur) duhet të jetë i njohur dhe i vlerësuar zyrtarisht nga autoritetet lokale dhe qendrore, dhe të përfshirë në evaluimin integral shkollor.
- Shkollat shumë-gjuhëshe duhet të inkurajohen dhe të mbështeten nga autoritetet lokale dhe qendrore për ta promovuar përkushtimin e tyre ndaj aktiviteteve të përbashkëta me nxënës publikisht.
- Kur është e mundur, aktivitetet e shkurta jashtë-mësimore që realizohen rregullisht në shkollat shumë-gjuhëshe (p.sh shfaqjet publike, shëtitjet, ngjarjet sportive) duhet të jenë të pranuar (nga komunitat, inspektorët) vetëm nëse realizohen si aktivitete të përbashkëta me nxënës nga të gjitha gjuhët mësimore.
- Përfshirja individuale e mësimdhënësve në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta duhet të konsiderohet zyrtarisht si pjesë e zhvillimit profesional të tyre.
- Shkollat shumë-gjuhëshe duhet të marrin mbështetje plotësuese për realizimin e aktiviteteve afatgjate jashtë-mësimore dhe/ose mësimore. Për shembull, mësimdhënësit që realizojnë aktivitete të përbashkëta afat-gjate (qoftë mësimore, siç janë orët e gjuhës Angleze, ose aktivitetet projektuese/orët e lira në shkollat e mesme, jashtë-mësimore, si punëtoritë multikulturore ose seksionet) në bazë të rregullt (një orë në javë gjatë tërë gjysmë vjetorit) mund të përfshijnë në numrin e kërkuar të orëve për angazhim të plotë të mësimdhënësve.

3. Para prezantimit të PINA-s, mësimdhënësit në përgjithësi nuk kishin vullnet për të mbajtur përgjegjësi për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me nxënës. Në fakt, te mësimdhënësit ka munguar kompetenca për të punuar me grupe “të përzier” të nxënësve dhe për të realizuar aktivitete të përbashkëta në mënyrë produktive dhe të sigurt. Si rezultat i kësaj, shumica e prindërve dhe nxënësve kanë besuar se këto aktivitete janë të porealizueshme derisa edhe në shkollat shumë-gjuhëshe. Shumica e mësimdhënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore (edhe nga shkollat një-gjuhëshe edhe nga ato shumë-gjuhëshe) nuk kanë bashkëpunuar lidhur me çështjet profesionale dhe rastet kur ata kanë pasur mundësi të takohen kanë qenë vetëm trajnimet e përbashkëta për zhvillim profesional të bazuara në lëndë.

Në kuadër të PINA-s, të gjitha shkollat në shtet (edhe shkollat një-gjuhëshe edhe shkollat shumë-gjuhëshe fillore dhe të mesme) kanë fituar material didaktik për realizimin e aktiviteteve të

përbashkëta me nxënës dhe mësimdhënësit e tyre fituan mundësi të përvetësojnë shkathtësitë e tyre për realizimin e këtyre aktiviteteve përmes trajnimeve të marra qoftë drejtpërdrejtë nga ekipi i projektit në ambient "të përzier" gjuhësor/etnik, qoftë në mënyrë të tërthortë nga kolegët e tyre të trajnuar në ambient shkollor. Trajnimet i kanë rritur kapacitetet bazike të shumë mësimdhënësve që të planifikojnë dhe të realizojnë në mënyrë të përbashkët aktivitetet me grupe "të përzier" të nxënësve dhe e kanë përforcuar gatishmërinë e tyre për tu kyçur në aktivitete të tilla. Njëkohësisht, PINA ka inkurajuar mësimdhënësit të kyçen në aktivitete tjera profesionale lidhur me mësimin, por ky mund ka pasur vetëm rezultate të kufizuara.

Është shumë e rekomanduar që sistemi të sigurojë trajnim nismëtar dhe trajnim për zhvillim të vazhdueshëm profesional për mësimdhënësit që të realizojnë aktivitete të përbashkëta me nxënës dhe që mësimdhënësit të marrin mbështetje nga sistemi për tu kyçur në bashkëpunim ndër-gjuhësor rreth aktiviteteve për zhvillim profesional:

- Njëra nga kërkesat për mësimdhënësit që punojnë ose aplikojnë të punojnë në shkolla shumë-gjuhëshe duhet të jetë që të kenë shkathtësi për planifikim dhe realizim të aktiviteteve të përbashkëta me nxënës.
 - MASH (përmes BZHA-së) është e përgjegjshme për sigurimin e trajnimeve të rregullta për zhvillimin dhe përmirësimin e shkathtësive të tilla të mësimdhënësit (edhe nga shkollat një-gjuhëshe edhe nga shkollat shumë-gjuhëshe) dhe poashtu ti detyrojë institucionet që janë për trajnimin e mësimdhënësve të përfshijnë kësi lloj shkathtësi në programet e tyre.
 - Pjesëmarrja në trajnimet për zhvillim profesional që synojnë zhvillimin e shkathtësive të tilla të mësimdhënësit duhet të konsiderohen si pjesë e zhvillimit profesional dhe të mirren parasysh në vlerësimin e mësimdhënësve.
 - Që të përforcohet bashkëpunimi profesional mes mësimdhënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore, të gjithë trajnimet për zhvillim profesional për mësimdhënësit të mbështetura dhe të siguruar nga MASH dhe institucionet e saja duhet të mbahen në rrethana shumë-gjuhëshe.
4. Para PINA-s, shumica e mësimdhënësve kanë qenë të vetëdijshëm për potencialet e aktiviteteve të përbashkëta për marrëdhëniet ndëretnike mes nxënësve, por përsëri i kanë mënjeluar. Në përgjithësi, mësimdhënësit, prindërit, dhe derisa edhe nxënësit i kanë perceptuar aktivitetet e përbashkëta si të rrezikshme dhe të porealizueshme sepse kontakti i drejtpërdrejtë mes nxënësve nga gjuhë/etnitet të ndryshme mësimore është shikuar si burim potencial për tensione ndëretnike dhe konflikte ndëretnike. Nxënësit (dhe të rriturit pranë tyre) nuk kanë qenë vetëm të stërngarkuar me stereotipe dhe paragjykitime etnike ndaj anëtarëve jashtë grupore, por ata po ashtu kanë qenë të gatshëm të manifestojnë ato haptazi. Kështu, shkollat shumë-gjuhëshe (në krahasim me shkollat një-gjuhëshe) janë shikuar si hapësirë ku janë shfaqur më shpesh konfliktet dhe stereotipet dhe paragjykitimet etnike janë manifestuar në mënyrë më të rregullt. Me qëllim që të parandalohen situata të tilla të padëshirueshme, shumë nga shkollat shumë-gjuhëshe kanë kufizuar mundësitë për kontakt të drejtpërdrejtë ndëretnik/ndërgjuhësor mes nxënësve dhe i kanë ndarë nxënësit (dhe mësimdhënësit) nga gjuhë të ndryshme mësimore në ndërrime të ndryshme ose objekte të ndryshme dhe pjesë të ndryshme të objekteve të njëjtë.

PINA ka arritur jo vetëm të shtyjë mësimdhënësit dhe nxënësit të praktikojnë aktivitetet e përbashkëta por po ashtu i ka bërë mësimdhënësit të besojnë në efektivitetin e këtyre aktiviteteve për përmirësimin e raporteve ndëretnike/ndërgjuhësore mes nxënësve/mësimdhënësve/prindërve nga gjuhë të ndryshme mësimore, si dhe për përmirësimin e atmosferës së përgjithshme në shkollë. Aktivitetet e përbashkëta janë shikuar si më të dobishme para së gjithash për reduktimin e stereotipeve dhe paragjykitimeve negative etnike dhe më pas për përforcimin e kontaktit ndëretnik/ndërgjuhësor dhe zvogëlimin e konflikteve mes nxënësve.

Ajo që nuk ka arritur PINA është të ndikojë në organizimin kohor/hapësinor të shkollave shumë-gjuhëshe. Shkollat që i kanë ndarë nxënësit në ndërrime ose objekte të ndryshme në bazë të linjave gjuhësore/etnike kanë mbetur në organizim të njëjtë. Kjo vazhdon të parandalojë kontakt të drejtpërdrejtë mes nxënësve nga gjuhë të ndryshme mësimore dhe po ashtu komplikon planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe shkurojnë mësimdhënësit që të angazhohen në to.

Është shumë e rekomanduar që sistemi të ndërmarrë masa që do ta maksimizojnë efektin e aktiviteteve të përbashkëta dhe do ta ndërprejnë paralelizmin që ekziston në shkollat shumë-gjuhëshe:

- Autoritetet qendrore dhe lokale duhet të zhvillojnë mekanizma për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta sipas kriterëve që sigurojnë efekte maksimale (grupe të balancuar “të përzier” etnikisht/gjuhësor të nxënësve, status të barabartë të gjuhëve, bashkëpunim drejt produktit/eve të përbashkët/a, dhe sa më shumë që është e mundeshë takime të rregullta).
- Autoritetet qendrore dhe lokale duhet të zhvillojnë mekanizma për ta ndërprerë ndarjen e pjesërisht dhe të plotë fizike mes nxënësve (dhe mësimdhënësve) nga gjuhë të ndryshme mësimore në shkollat shumë-gjuhëshe. Në vend se të shpërndahen nxënësit në ndërrime ose objekte/pjesë të ndryshme të objekteve shkollore sipas gjuhës mësimore, kriteri i klasës/vitit mund të aplikohet edhe në shkollat fillore edhe të mesme (nxënësit më të rinjë në një ndërrim/objekt, dhe nxënësit më të vjetër në tjetër).